Kultura nuk është e dhënë, por është krijuar nga njerëzimi dhe është e lidhur ngushtë me qytetërimin njerëzor. Sipas Komitetit për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR), koncepti i “kulturës” përfshin: “mënyrën e jetesës, gjuhën, letërsinë gojore dhe të shkruar, muzikën dhe këngën, komunikimin jo verbal, besimin fetar, ritet dhe ceremonitë, sportet dhe lojërat, metodat e prodhimit ose teknologjinë, mjediset natyrore dhe të krijuara nga njeriu, artet, veshjet dhe strehimin, ushqimin ku komunitetet dhe individët ndërtojnë ekzistencën e tyre, i japin kuptim jetës dhe shprehin humanizmin e tyre³. Trashëgimia kulturore përfaqëson identitetin e një grupi apo komuniteti të caktuar. Kjo njihet nga Konventa e UNESCO-s e vitit 2003 për “Mbrotjtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale” (Sahu & Mahanta 2017), përmbajtja e asaj trashëgimie kulturore jomateriale u siguron “komuniteteve dhe grupeve të ndryshme një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie”. E njëjta gjë vlen edhe për trashëgiminë kulturore të prekshme. Sasia e mirëqenies, materiale dhe jomateriale, që gjeneron trashëgimia për shoqërinë janë faktorë përcaktues të vlerës së saj ekonomike.

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për këtë studim përfshin një kombinim inovativ të teknikave të vlerësimit ekonomik dhe social. Teknikat e vlerësimit ekonomik të aplikuara përfshijnë analizën e zinxhirit të vlerës, analizën e koeficientit të vendndodhjes, analizën e performancës së industrisë dhe hartimin e përqendrimit të industrisë. Këto teknika kryesisht përfshijnë punën me të dhëna statistikore të disponueshme nga burime qeveritare në nivel lokal të analizës. Analiza përfshin

² Lagrange, Oter & Uerpmann-Wittzac, 2018,f.2

³ Northern Irlandë human Rights Komisioni, 2013, fq. 3

gjithashtu një rishikim të dinamikës së sektorëve kulturorë dhe të lidhur brenda ekonomive lokale të bashkive të përzgjedhura të studimit të rastit.

Vlerësimi social kombinoi teknika të tilla si hartimi i aseteve të trashëgimisë kulturore, analiza e palëve të interesuara dhe analiza institucionale, si dhe një ekzaminim të mjedisit më të gjerë shoqëror. Në nivel lokal (në vendet e studimit të rastit), teknikat më të rëndësishme të aplikuara përfshijnë konsultimin me palët kryesore të interesuara (zyrtarë lokalë, OJQ, aktivistë të komunitetit, akademikë, etj.) dhe hartimin e aseteve me pjesëmarrje. Vlerësimet sociale dhe ekonomike të kryera në nivel lokal u përdorën për të përgatitur një analizë gjithëpërfshirëse SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) për çdo vend, e cila u nda me palët e interesuara lokale.

Rishikim literature

Trashëgimia kulturore në dyzet vitet e fundit është bërë jo vetëm sinonim i monumenteve, artefakteve arkeologjike, kulturës, identitetit rajonal dhe kombëtar, por kuptimi dhe marrëdhënia e saj me turizmin është më e dukshme dhe ka evoluar. Pavarësisht tendencave ekonomike dhe paqëndrueshmërisë së tregut, turizmi ka vazhduar të rritet dhe zhvillohet dhe vlerat e tij lidhen jo vetëm me zhvillimin ekonomik, por edhe me çështjet socio-kulturore dhe mjedisore (Hooper, 2016). Investimet në trashëgiminë kulturore (dhe forma të tjera të kulturës) shpesh pretendohen të jenë të dobishme për një ekonomi lokale, në formën e rritjes së punësimit dhe të ardhurave. Në këtë artikull do të trajtojmë disa pyetje metodologjike në lidhje me studimet e ndikimit ekonomik të investimeve në projektet e trashëgimisë kulturore.

Turizmi i trashëgimisë po rritet më shpejt se çdo sektor tjetër i industrisë së turizmit, me një numër të madh njerëzish që vizitojnë vendet kulturore dhe historike, dhe shihet si i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e varfërisë në mbarë botën⁴. (Ky lloj turizmi përfshin të gjitha elementet kulturore të prekshme, të ndërtuara si kështjellat, ndërtesat historike, katedralet, shtëpitë,

⁴ UNWTO 2005

muzetë, fermat dhe reliket arkeologjike, si dhe elementet e paprekshme si gjuha, festivalet, muzika, feja, ushqimi, etj. Në ditët e sotme industria e trashëgimisë gjithashtu njihet peizazhe që portretizojnë jetën e njerëzve në familjet e tyre, jetën e minatorit, peshkatarit, fëmijëve, burrave dhe grave⁵.

Trashëgimia është universale dhe i përket të gjithëve, ka të bëjë me kulturën, historinë, objektet natyrore dhe të ndërtuara. Menaxhimi i trashëgimisë është shpesh kompleks dhe problematik për identitetin dhe kulturën lokale të një vendi. Menaxhimi i bazuar në vlerë shihet ndër qasjet më të rëndësishme për menaxhimin e trashëgimisë, dhe vendet e trashëgimisë publike zakonisht menaxhohen nga menaxherë profesionistë, por jo nga ata privatë⁶.

Trashëgimia kulturore sipas Ligjit të shtetit Shqiptar nr. 10 137 datë 11.5.2009 “Për Trashëgiminë Kulturore” përbëhet nga vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare.

I. Vlerat materiale të trashëgimisë kulturore janë:

1. Objekte të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, ku përfshihen:

- Qendra, zona dhe rajone, të banuara ose të pabanuara, me vlerë arkeologjike, historike, etnologjike, arkitektonike dhe inxhinierike, objektet e kësaj natyre në gjendje rrënojë, me vjetërsi mbi 100-vjeçare;
- Ansamble urbane, arkitekturore dhe historike, ndërtime ose konstruksione ndërtimore me vlera të veçanta, objektet e kësaj natyre në gjendje rrënojë, me vjetërsi mbi 100-vjeçare.

2. Objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, ku përfshihen:

- Objekte, pjesë ose elemente të objekteve, të përfshira në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, si mozaikë, kolona, kapitule, skulptura, piktura murale, ikona, ikonostase, tavane karakteristike, mbishkrime, gurë varresh, me vjetërsi mbi 100-vjeçare.

⁵ Timothy & Nyaupane, 2009, f. 3

⁶ Howard, 2003, f. 1

- Materiali i lëvizshëm arkeologjik, grumbullohet nga gjurmimet arkeologjike.
- Krijimet artistike të të gjitha llojeve dhe gjinive.
- Dokumente arkivore me rëndësi historike kombëtare.
- Dorëshkrime dhe botime, libra dhe periodikë me vlera të veçanta, historike dhe bibliografike.
- Koleksionet e ndryshme filatelike, numizmatike të artit, me vjetërsi mbi 25-vjeçare.
- Pajisje tradicionale pune, mjeshtërie dhe jetese. Mekanizma, makineri ose objekte të përdorimit të përditshëm ose atij ceremonial, me vlera artizanale, etnografike ose historike, objektet e prodhuara në mënyrë artizanale, mbi 50-vjeçare dhe objektet e fabrikuara mbi 75- vjeçare.
- Teknologji të prodhimit të produkteve të traditës.
- Armët e ftohta dhe të zjarrit, të prodhimit artizanal ose të fabrikuara përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore.
- Objekte personale të figurave të shquara historike.
- Objektet e përfshira në inventarët e pasurive, të institucioneve shtetërore të vendit deri në vitin 1991.

II. Vlerat jomateriale të trashëgimisë kulturore janë:

- Përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare.
- Folklori gojor i ruajtur në kujtesë, i shkruar ose i regjistruar.
- Folklori vokal, koreografik dhe instrumental.
- Zakone dhe doke tradicionale.
- Besime dhe besëtytni të traditës.
- Zejet e ndryshme tradicionale.

Trashëgimia jomateriale përbëhet nga elementet që përfaqësojnë kulturën në çdo komunitet, të cilat shprehen në një sërë veprimesh, mënyrash të të folurit dhe të menduarit, përsëritja simbolike e fakteve historike dhe nga vendosja e etikës ose rregullave morale.

Në këtë artikull, japim gjithashtu një përmbledhje të shkurtër mbi disa studime të ndikimit ekonomik të aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe/ose turistike, si dhe të mirat dhe të këqijat e këtyre studimeve. Në një studim të qytetit norvegjez të Røros, është zbuluar

se turizmi i lidhur me trashëgimitë kulturore në rajon kontribuon rreth 7 për qind në punësimin dhe të ardhurat e përgjithshme. Trashëgimia kulturore është një mënyrë e të jetuarit që një komunitet e ka trashëguar nga brezat e mëparshëm dhe që ia kalon brezit pasardhës.

Një tjetër punim që përmbledh gjetjet e një aktiviteti analitik është kryer në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi) i financuar nga Fondi Italian i Mirëbesimit për Trashëgiminë Kulturore. Ky aktivitet u fokusua në identifikimin e praktikave të mira dhe sfidave për rritjen e kontributit të aktiviteteve të trashëgimisë kulturore në zhvillimin ekonomik lokal në Ballkanin Perëndimor. Ky punim u krye në një kohë kur Banka Botërore kishte mbështetur trashëgiminë kulturore në Europë dhe Azinë Qendrore përmes një sërë aktiviteteve dhe operacionesh huadhënieje nga viti 1997 – 2008.

Me përfundimin e këtij rishikimi dolën një sërë konkluzionesh të rëndësishme:

- Projektet që trajtojnë bashkërisht ruajtjen e trashëgimisë, zhvillimin e komunitetit ka të ngjarë të krijojnë sinergji pozitive që stimulojnë rritjen ekonomike.
- Ruajtjen kulturore dhe projektet e turizmit në komunitet kanë efekte të rëndësishme shumëfishuese.
- Rëndësinë e një qasjeje të decentralizuar që angazhon qeverinë vendore në vendimet për kujdesin dhe përdorimin e aseteve të trashëgimisë.

Nisur nga këto konkluzione dhe me mbështetjen e Fondit Italian të Trashëgimisë Kulturore, u vendos që të shqyrtohet më thellë sinergia midis Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Trashëgimisë Kulturore.

Qëllimi i kësaj pune analitike ishte identifikimi i mekanizmave dhe opsioneve për të arritur një rritje ekonomike të udhëhequr nga kultura që mund të sigurojë mbështetje të mundshme nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve.

Metodologjia e miratuar për këtë studim përfshinte një kombinim inovativ të teknikave të vlerësimit ekonomik dhe social. Teknikat e vlerësimit ekonomik të aplikuara përfshinin analizën e zinxhirit të vlerës, analizën e koeficientit të vendndodhjes, analizën e performancës së industrisë dhe hartimin e përqendrimit të industrisë.

Në të vërtetë, çdo fushë e kulturës, që nga ajo e industrisë krijuese ndaj trashëgimisë kulturore, dihet se prodhon punësim dhe të ardhura. Turizmi kulturor, për shembull, përbën rreth 40% të totalit të shumës së të ardhurave nga turizmi⁷. Për më tepër, trashëgimia kulturore është e lidhur me zhvillimin shoqëror ose njerëzor dhe trashëgimia kulturore është qartësisht e ndërlydhur me të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Trashëgimia kulturore konsiderohet gjithnjë e më shumë si një shtytës për zhvillimin e qëndrueshëm në fusha të ndryshme si sociale, kulturore gjithëpërfshirëse dhe zhvillimi ekonomik, harmoninë mjedisore, qëndrueshmërinë dhe ndërtimin e paqes.

Një tjetër pikë diskutimi është pyetja nëse trashëgimia vlerësohet ende si e rëndësishme për vlerat e brendshme. Vlerat historike dhe vlerat estetike konkurrojnë me vlerat sociale dhe ekonomike.

Gjithnjë e më shumë vlera e trashëgimisë për shoqërinë theksohet duke argumentuar faktin se trashëgimia ka një ndikim të rëndësishëm social dhe ekonomik.

Trashëgimia kulturore si një shtysë në rritjen ekonomike të komuniteteve lokale. Rajoni jugor Sarandë.

Shqipëria është një vend i lashtë, me histori shumë të pasur. Në periudha të ndryshme të historisë, në vendin tonë janë kryqëzuar qytetërimet, kulturat dhe fetë më të rëndësishme të historisë së njerëzimit. Trashëgimia jonë kulturore, shumë e pasur për përmasat e vendit tonë, është dëshmi elokumente e një të shkuare që ka prodhuar kaq shumë histori. Gjirokastra, Saranda dhe rrethinat e tyre kanë shumë potencial për zhvillimin e turizmit të trashëgimisë.

Për vlerat e shumta historike, kulturore, artistike, arkitekturore etj., kjo trashëgimi është njëherazi edhe një burim shumë i pasur për zhvillimin e turizmit kulturor në Shqipëri, i cili mbetet ende në hapat e tij të parë në vendin tonë. Pjesë shumë e rëndësishme e këtij turizmi kulturor do të ishte turizmi fetar, pasi, në Republikën e Shqipërisë numërohen rreth 220 objekte kulti që janë pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar.

⁷ Bandarin, Hosagrahar dhe Sailer Albernaz 2011: 15-18

Butrinti është një sit i Trashëgimisë Botërore që në 1992, është një zonë e mbrojtur e cila u bë një Park Kombëtar Shqiptar në vitin 2001 dhe një Zonë Ligatinore e Ramsarit me rëndësi ndërkombëtare në vitin 2003. Parku përfshin një peizazh të paprishur dhe të larmishëm malesh, ultësirash, fushash të hapura, liqenesh, dhe lagunash. Parku i Butrintit si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s ka marrë financime dhe asistencë teknike në nivele ndërkombëtare si dhe financim dhe asistencë teknike nga një fondacion jashtëzakonisht efektiv për disa vite rresht. Gjithashtu vlerësohet shumë nga qeveria si një nga vendet më të rëndësishme kulturore në Shqipëri. Megjithatë, rëndësia e tij mund të mos e mbrojë atë nga presionet ekstreme për zhvillim që përballen zonat bregdetare të vendit. Komuniteti i zonës hyrëse në Butrint, Saranda si dhe komuniteti ngjitur me parkun (Ksamil) po vuajnë tashmë nga mbizhvillimi për shkak të këtij presioni. Ky përbën një kërcënim serioz për zhvillimin e një prej atraksioneve turistike potencialisht më të suksesshme. Nëse ky kërcënim mund të shmanget, parku mund të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin rajonal dhe të veprojë si një model për format e qëndrueshme të turizmit, mbrojtjen e mjedisit dhe aktivitete të tjera tregtare.

Vendet e trashëgimisë kulturore të lidhura me parkun përfshijnë:

- Vende arkeologjike dhe mbetje nga epoka greke, romake, bizantine, anzhvine, veneciane dhe osmane.
- Ai përbëhet gjithashtu nga një grup i pasur habitatesh, duke përfshirë ligatinat bregdetare, lagunat me ujë të kripur, lumenjtë, liqenet dhe tokat e hapura të kullotave. Ky kombinim unik i arkeologjisë dhe natyrës krijon një atmosferë të veçantë të largët dhe “të pazbuluar” që nuk gjendet në asnjë vend tjetër të rëndësishëm arkeologjik në Mesdhe.
- Zhvillimi i artizanatit, i mbështetur nga një grant i vogël i Bankës Botërore në komunitetet përreth parkut, ka rezultuar në një njësi të njohur artizanale që shet suvenire që bazohen në vlerat e trashëgimisë së parkut.
- **Fshatrat e vegjël ruralë** ngjitur me parkun janë komunitete simpatike bujqësore që nuk i **kanë zhvilluar ende asetet e tyre të trashëgimisë.**
- **Ksamil**, brenda kufijve të zgjeruar së fundmi të parkut, ka

pamje të bukura nga deti dhe plazhe, të cilat kërcënohen nga mbizhvillimi.

Saranda, një port detar që shërben dhe si portë turistike për parkun, ka disa vende arkeologjike, kështjella dhe manastire, por këto nuk janë të promovuara mirë dhe shpesh anashkalohen nga vizitorët. Me një strategji të përshtatshme zhvillimi dhe mbështetje dhe inkurajim të fortë, këto komunitete mund të jenë në gjendje të mbrojnë efektivisht burimet e tyre kulturore dhe natyrore dhe të bëhen pasuri në një grup turistik. Bashkia e Sarandës ka në shërbim zyrën e trashëgimisë kulturore me këtë organizim: Kjo zyrë ka një inventar ku përfshihen 110 monumente të kategorive të ndryshme. Për trashëgimitë kulturore ka dy harta, një për zonifikimin arkeologjik, Sarandë dhe tjetra për monumentet e kulturës të rajonit Sarandë – Delvinë. Drejtoria ka gjithsej 11.

Çdo investim që bëhet në territorin e bashkisë, në infrastrukturë dhe në ambiente rekreative, në sipërfaqe të gjelbra dhe rehabilitime është në funksion të turizmit. Buxheti i Bashkisë për vitin 2021 ishte 18.5 milionë lekë. Në të përfshihen aktivitete që shoqërojnë sezonin, pjesëmarrja nëpër panairë, dhe marketingu. Gjatë vitit 2022 promovimi, brandimi dhe marketingu i destinacionit është zhvilluar nga FSHZH, projekt i BB. (Bashkia Sarandë, Zyra e turizmit dhe Trashëgimisë kulturore).Të ardhurat nga aktiviteti i turizmit për vitet 2018-2021 paraqiten në Tabelë:

Vitet	Subjekte private gjithsej	Subjekte shërbime turistike	Të ardhura nga turizmi kundrejt tëardhurave totale
2018	1596	345	26%
2019	1845	437	32.2%
2020	2065	483	37.3%
2021	2303	801	28.3%

Burimi. Zyra tatimore Sarandë.

Finiqi është një bashki kufi me bashkinë e Sarandës dhe mbart një potencial të pashfrytëzuar të Trashëgimisë Kulturore. Në këtë

bashki është dhe Syri i Kaltër që pas Butrintit është destinacioni më i frekuentuar nga turistët. Bashkia e Finiqit është bashki e re dhe si e tillë tani është dukëngritur strukturat e turizmit duke planifikuar në buxhetin e vitit 2023 një fond modest për desitinacionet turistike që ajo ka.

Përfundime dhe rekomandime

- Për rritjen e rolit të Trashëgimisë Kulturore në zhvillimin ekonomik lokal kusht themelor është një mjedis legjislativ i përshtatshëm që mbron në mënyrë adekuate asetet e Trashëgimisë Kulturore lokale dhe kombëtare.
- Projektet që trajtojnë bashkërisht ruajtjen e trashëgimisë, zhvillimin e komunitetit dhe objektivat e turizmit ka të ngjarë të krijojnë sinergji pozitive që stimulon rritjen ekonomike.
- Në disa raste, kur fokusi i krijimit të punësimit është një prioritet, grantet konkurruese për të inkurajuar përmirësimet dhe investimet përkatëse mund të jenë një alternativë e denjë.
- Përveç financimit, mungesa e kapaciteteve institucionale dhe e aftësive teknike përbëjnë barriera plotësuese për realizimin e potencialit të trashëgimisë kulturore.

Lista e shkurtimeve

CESCR - The Committee on Economic, Social and Cultural Rights UNESCO - United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization OJQ - Organizata Joqeveritare
UNWTO - Organizata Botërore e Turizmit ZHEL - Zhvillimi ekonomik Lokal

BIBLIOGRAFIA

GORICA K.(2015), "Menaxhimi i Turizmit të Qendrushëm" f..22
UNESKO (2003), "Koventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale
LIGJI SHQIPËTAR (2009) "Per Trashëgiminë Kulturore nr.10137 11 Maj.
HOPER G. (2016). *Heritage And Tourism In Britain And Ireland*. Glasgow (UK):
Palgrave Macmillan. HOWARD P. (2003), *Heritage: "Management,*

- Interpretation, Identity*” London And New York: Continuum. f.1. SAHAHU N. & MAHANTA N. R. (2017). *Unit 5 - Festivals And Rituals*, IGNOU. [Http://Egyankosh.Ac.In/Bitstream/123456789/38963/1/Unit-5.Pdf](http://Egyankosh.Ac.In/Bitstream/123456789/38963/1/Unit-5.Pdf).
- TIMOTHY D. J. & NYAUPANE G.P. (2009), “*Cultural Heritage And Tourism*” *In The Developing World: A Regional Perspective*. London And New York: Routledge. f.3
- UNESCO (2017). *What Is Meant By “Cultural Heritage”?*. [Http://Www.Unesco.Org/New/En/Culture/Themes/Illicit-Trafficking-Of-Cultural-P](http://Www.Unesco.Org/New/En/Culture/Themes/Illicit-Trafficking-Of-Cultural-P)
- NORTHEM IRLAND HUMAN (2013) Rights Commission. (2013) *The Display Of Flags, Symbols And Emblems In Northern Ireland*. [Https://Www.Nihrc.Org/Uploads/Publications/104020_NIHRC_The_Display_Of_Flags_Single Column V7 Final Low Res.Pdf](https://Www.Nihrc.Org/Uploads/Publications/104020_NIHRC_The_Display_Of_Flags_Single_Column_V7_Final_Low_Res.Pdf).
- DALLAIRE & COLBERT (2012)
- LAGRANDE E.; OETERS. & UPERMAN-WITZACK R. (2018), *Cultural Heritage And International Law: “Obcts, Means And Ends Of International Protection*) Germany: Springer.
- F LIU, J. C. (2005). “Tourism And The Value Of The Culture In Regions”*The Annals Of Regional Science*, Vol. 39, No. 1, f. 1-9.
- SALVATORE C.L.(2018). “*Cultural Heritage Care And Management: Theory And Practice*” Maryland (USA): Rowman& Littlefield.f, 2.
- SILVERMAN H. & RUGGLE F. (2007). “*Cultural Heritage And Human Rights*”. New York (USA): Springer. SMITH L. (2006). “*Uses Of Heritage*”. London And New York: Routledge.
- TAHIRI A. & KOVAÇI I. (2017). *Menaxhimi Në Turizëm: “Qasje Teorike Menaxheriale/ Management In Tourism”*: Theoretical Managerial Approach, Peja, Kosovo: Research Center.

“LEXIMI” EFEKTIV I ASETETEVE TË TRASHËGIMISË SI ELEMENT JETIK PËR TRANSMETIMIN KULTUROR

VASILIKA RRAKU

Filiali Sarandë
Universiteti i Tiranës
rraku.vasilika@gmail.com

ABSTRACT

The aim of this article is to point out the importance of correct interpretation of cultural heritage data as the cornerstone of cultural heritage transmission, focusing on three main stages of vital importance to this process: Perception, interpretation and communication. Perception is considered to be the first stage of acquiring information from heritage assets through the use of all senses. Interpretation is the stage of assigning meaning to observed stimuli based on previously acquired knowledge of the field. The aptitude of correct interpretation lies on several closely related factors, such as the person's general knowledge of the area of study, observation skills, the ability to “read” through the images and symbols making use of the imagination, construction of meaning, etc. The last stage in the process of cultural transmission is communication, which can be performed in two forms, verbal and non-verbal. The article continues with an explanation of the principal communication techniques for successful transmission of the cultural heritage, giving special emphasis to the importance of body language in interpersonal and small-group communication and the importance of using virtual technologies in public and mass communication. Finally, the article concludes with several suggestions on the ways of transmitting cultural heritage effectively through proper perception, interpretation and communication of heritage assets.

Keywords: Heritage assets, perception, interpretation, communication, transmission, stages

Trashëgimia kulturore është një element i padiskutueshëm i identitetit kombëtar. Ajo të jep mundësinë të kuptosh traditat specifike të paraardhësve, duke i parë ato në këndvështrimin historik për të arritur tek të kuptuarit e asaj që ne jemi. Në dekada, që nga miratimi i Konventës së Trashëgimisë Botërore, ‘krizat’ e ndryshme të përkufizimit kanë ndikuar ndjeshëm në mënyrat në të cilat trashëgimia klasifikohet, perceptohet dhe menaxhohet në shoqëritë bashkëkohore globale.¹ Trashëgimia mund të ndahet në dy kategori kryesore. Nga njëra anë, ekziston një trashëgimi që paraqitet në një formë materiale, të prekshme: arkeologji, art, objekte të luajtshme, arkitekturë dhe peizazh.

Nga ana tjetër, ekziston një formë tjetër e trashëgimisë, e cila quhet “trashëgimia kulturore jomateriale”². Ky emërtim u konceptua në mënyrë që të njiheshin dhe të merreshin në konsideratë disa realitete, të cilat mbetën të padukshme për një periudhë të gjatë kohore dhe që nuk përshtateshin si pjesë e ndonjë kategorie tjetër të krijuar të trashëgimisë. Ajo përfshin traditat ose shprehjet e gjalla të trashëguara nga paraardhësit tanë dhe të përcjella te pasardhësit tanë, si gojëdhënat, artet e skenës, ritualet, ngjarjet festive, njohuritë dhe praktikat në lidhje me natyrën dhe universin ose njohuritë dhe aftësitë për të prodhuar zanate tradicionale.

Trashëgimia kulturore jomateriale është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e diversitetit kulturor përballë globalizimit në rritje. Kuptimi i trashëgimisë kulturore jomateriale të komuniteteve të ndryshme ndihmon në dialogun ndërkulturor dhe inkurajon respektin e ndërsjelltë për mënyra të tjera të jetesës. Rëndësia e trashëgimisë kulturore jomateriale nuk është vetë manifestimi kulturor, por pasuria e njohurive dhe aftësive që transmetohet nëpërmjet saj nga një brez në tjetrin.

Vlera sociale dhe ekonomike e këtij transmetimi të njohurive është e rëndësishme si për grupet minoritare dhe për grupet kryesore shoqërore brenda një shteti, dhe është gjithashtu po aq e rëndësishme për shtetet në zhvillim sa edhe për ato të zhvilluara. Trashëgimia kulturore duhet të prezantohet në botë, sepse ajo afirmon identitetin tonë si popull dhe krijon një kornizë gjithëpërfshirëse për ruajtjen e saj.

¹ Anders Högberg (2016), Rodney Harrison: Heritage. Critical Approaches, Routledge, Londër.

I. Perceptimi, interpretimi dhe komunikimi i trashëgimisë kulturore

Trashëgimia është një koncept i vështirë për t'u përcaktuar, sepse mund të mbulojë një grup të madh objektsh dhe idesh në dukje të ndryshme. Këto variojnë nga një lidhje e fortë me tokën përmes stileve specifike të artit dhe manifestimeve të dallueshmërisë kulturore deri tek produktet komerciale për prodhimin e të cilave janë përdorur proceset tradicionale të prodhimit të tyre. Në një nivel të përgjithshëm, trashëgimia është diçka që individët në mënyrë emocionale pretendojnë se e kanë të tyren ose e shohin si të dikujt tjetër, por gjithmonë si diçka që përcillet nga brezat e mëparshëm. Perceptimi i trashëgimisë kulturore kushtëzohet si nga gjendja e vëzhguesit ashtu edhe nga artisti. Stilet e artit zhvillohen nga një vendim i vullnetshëm i një artisti që e hedh frymëzimin e tij në formë vizuale brenda trajektoreve historike dhe vjen si një deformim koherent në traditat e trashëguara.

Në art, kuptimet e marra nga perceptimi përqendrohen në shprehjen vizuale dhe stili përfaqëson “një interpretim, një mënyrë fakultative të përshkrimit të botës.”³ Për realizimin e perceptimit të saktë të formave të ndryshme të trashëgimisë kulturore vijnë në ndihmë skemat kulturore. Skemat kulturore janë pasqyrime orientuese të përbashkëta shoqërore që aktivizohen në njohjen automatike. DiMaggio i përkufizon skemat si “struktura njohurish që pasqyrojnë objekte ose ngjarje dhe ofrojnë supozime të paracaktuara rreth karakteristikave të tyre, lidhjeve dhe konkluzioneve në kushtet e informacionit jo të plotë” (DiMaggio 1997) ⁴.

Konceptualizimi i “supozimeve të paracaktuara” është një përshkrim i qartë dhe i matur i skemave si mjete të kompletimit të modeleve që plotësojnë pjesët e munguara të njohurive me paracaktimet e mësuara kulturore. Kështu, skemat përkatëse plotësojnë informacionin që mungon duke na lejuar të perceptojmë copëzat e shkëputura si pjesë e një tërësie kuptimplote. Ndërsa qëllimi i skemave

³ Merleau-Ponty M., (2012), *Phenomenology of Perception*, Routledge, UK

⁴ DiMaggio, P. (1997), *Culture and Cognition*, në “*Annual Review of Sociology*”, Volumi 23, fq. 263–287.

stereotype është plotësimi i informacionit që mungon, funksioni i parë i skemave kategorizuese është moskonsiderimi i informacionit që është i pavend. Kategorizimi i objekteve thjeshton botën e perceptuar sepse lejon që objekte të ndryshme të trajtohen si ekuivalente (Goldstone, Kersten dhe Carvalho 2018)⁵.

Ky proces funksionon kryesisht duke lidhur në mënyrë holistike stimulën me paraqitjet njohëse të prototipeve. Aktivizimi i një kategorie të nënkuptuar mund të rezultojë përfundimisht në aktivizimin e një stereotipi. Skemat kulturore mund të ndikojnë mbisjelljen në të paktën dy mënyra relativisht të drejtpërdrejta: (i) si kategori të nënkuptuara, stereotype dhe grupe të tjera të “supozimeve të paracaktuara” automatike, të cilat ndikojnë mbi atë që njerëzit perceptojnë, mbajnë mend ose kuptojnë lidhur me çfarë thonë të tjerët dhe (ii) si norma të brendshme, intuited morale dhe receta kulturore të zakonshme, që shkaktojnë veprime të drejtpërdrejta nëpërmjet proceseve njohëse të ngjashme me refleksin, të cilat ndodhin pa vetëdijen dhe kontrollin e ndërgjegjshëm të individëve. (DiMaggio 1997) Interpretimi, si faza e dytë e transmetimit të trashëgimisë kulturore, i referohet gamës së plotë të aktiviteteve të mundshme që synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të kuptuarin e publikut në lidhje me burimet e trashëgimisë kulturore⁶. Interpretimi dhe prezantimi efektiv duhet të përmirësojë përvojën personale, të rrisë respektin dhe mirëkuptimin e publikut, si dhe të komunikojë rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Individët dhe komunitetet inkurajohen të reflektojnë vetë perceptimet e një monumenti të trashëgimisë kulturore dhe ndihmohen në krijimin e lidhjeve kuptimplote me të, me qëllimin për të nxitur më tej interesin, mësimin, përvojën dhe eksplorimin.

Interpretimi duhet të shfaqë gamën e informacioneve verbale dhe të shkruara, gjetjeve materiale, traditave dhe kuptimeve që i atribuohen një burimi të trashëgimisë kulturore. Interpretimi duhet të mbështetet në një hulumtim shumëdisiplinar të mirëstudjuar të monumentit kulturor dhe rrethinave të tij. Gjithashtu duhet të pranojmë se interpretimi kuptimplotë përfshin domosdoshmërisht reflektimin mbi

⁵ Robert L. Goldstone, Alan Kersten, Paulo F. Carvalho (2018), Concepts and Categorization, në “Handbook of Psychology”, botimi i dytë

⁶ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec

hipotezat historike alternative, traditat vendore dhe tregimet.

Në vendet e trashëgimisë kulturore ku tregimet tradicionale ose kujtimet e pjesëmarrësve historikë ofrojnë një burim të rëndësishëm informacioni rreth rëndësisë së vendit, programet interpretuese duhet t'i përfshijë këto dëshmi gojëdhënore, qoftë në mënyrë indirekte, nëpërmjet infrastrukturës, ose drejtpërdrejt, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të komuniteteve të lidhura me to. Rindërtimi vizual, qoftë nga artistët, arkitektët, apo modeluesit kompjuterikë, duhet të mbështetet në analizën e detajuar dhe sistematike të të dhënave mjedisore, arkeologjike, arkitekturore dhe historike, përfshirë analizën e burimeve të shkruara, gojëdhënore, ikonografike dhe fotografike.⁷

Komunikimi, si faza e tretë e transmetimit të trashëgimisë kulturore, luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për promovimin e trashëgimisë kulturore, por edhe për stimulimin e zhvillimit të turizmit. Komunikimi për turizmin e qëndrueshëm lokal do të përfshijë përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi një gamë të gjerë pasurish vendore, natyrore, peizazhesh kulturore, traditash të trashëgimisë, zanatesh dhe aftësish, ngjarjesh kulturore, si dhe mbi artin dhe kulturën bashkëkohore.⁸

Disa nga përparësitë e komunikimit të qartë të vlerave të trashëgimisë janë:

- Operatorët turistikë mund të zhvillojnë produkte unike dhe më të sofistikuar, si dhe të ofrojnë përvoja që u përshtaten më mirë interesave të vizitorëve, duke krijuar diferencim të produktit dhe rezultate konkurruese.
- Menaxherët e trashëgimisë dhe operatorët turistikë mund të nxisin mbështetjen për ruajtjen e trashëgimisë, duke u siguruar që vlerat e rëndësishme të një vendi të mos ndikohen negativisht nga aktivitetet apo produktet turistike.
- Vizitorët bëhen shumë më të vetëdijshëm për çështjet mjedisore dhe dallimet ndërmjet kombeve dhe kulturave.

Komunikimi i trashëgimisë mund të ushtrojë gjithashtu një ndikim të fuqishëm në mënyrën se si e sheh atë komuniteti pritës dhe në

⁷ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec.

⁸ UNWTO (2011), Communicating Heritage – A Handbook for the Tourism Sector, World Tourism Organization, Madrid, Spanjë.

reagimin e tij ndaj aktivitetit turistik lokal. Ai mund të rrisë vlerësimin e komunitetit për burimet e ndryshme lokale që mund të mbështeten nga shpenzimet turistike, të tilla si atraksionet natyrore ose kulturore.

Përveç formës verbale, ku studimi i gjuhës mund të përdoret për të kuptuar sjelljen dhe përvojën njerëzore,⁹ komunikimi kulturor mund të realizohet edhe në formën joverbale, përmes gjesteve dhe gjuhës së trupit. Përdorimi i gjuhës gjestike merr rëndësi dhe ka vlerë më të madhe në mjedisin global multikulturor, me dallime demografike dhe kulturore si gjuha, rajoni, gjinia, mosha, feja, etj.

Gjuha gjestike zhvillon marrëdhëniet multikulturore, kompetencën, mirëkuptimin dhe harmoninë sociale dhe heq pengesat dhe konfliktet multikulturore. Ajo mundëson jo vetëm ndërthurjen e njerëzve me kulturat e ndryshme, por edhe shpalosjen e kapitalit kulturor dhe social e njerëzor. Kështu, përdorimi i gjuhës gjestike luan një rol të rëndësishëm për të siguruar një komunikim efektiv multikulturor.¹⁰

Komunikimi i aseteve të trashëgimisë kulturore përmes rristurimit të tyre duhet të kontribuojnë në ruajtjen e autenticitetit duke komunikuar rëndësinë e tyre, pa ndikuar negativisht në vlerat kulturore që mbartin apo ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme strukturën e tyre. Të gjitha infrastrukturat e dukshme interpretuese duhet të jenë të ndjeshme ndaj karakterit, mjedisit dhe rëndësisë kulturore dhe natyrore të vendit.¹¹ Aq më tepër tashmë, që mënyrat e komunikimit kanë ndryshuar dhe dixhitalizimi i njohurive dhe informacionit thjeshton marrjen e informacionit më të përpunuar dhe demokratizon disponueshmërinë e njohurive specifike të orientuara ndaj subjektit (Borgmann 2010)¹². Për më tepër, mundësitë e ndryshme që rezultojnë nga teknologjitë dixhitale kanë ndikim të madh në paraqitjen e informacionit dhe perceptimin e tij.

Trashëgimia kulturore tashmë i nënshtrohet një larmie të madhe detyrash komunikimi të kryera në një mori mënyrash nga shumë

⁹ Vivien B. (2015), Social Constructionism, botimi i tretë, Routledge, Londër.

¹⁰ Jaya N. (2011), Importance of Body Language in Effective Multicultural Communication, në <https://typeset.io/pdf/importance-of-body-language-in-effective-multicultural-572wnkfjym.pdf>

¹¹ ICOMOS (2008), Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites, Québec

¹² Albert B. (2010), Reality and Technology, në “Cambridge Journal of Economics”, Volumi 34, Faqja 27-35.

metodologji të ndryshme. Trashëgimia dhe vlerat e saj komunikohen përmes turneve në qytet, ekspozitave, faqeve të internetit, fletëpalosjeve, librave, aplikacioneve për smartphone, faqeve të internetit, lojërave, mësimëve të artit në shkollë dhe shumë aktiviteteve dhe rrugëve të tjera.¹³

Kështu, lind sfida e trajtimit të mospërputhjes së brendshme të dy identiteteve antagonistë (individualitetit/veçantisë dhe pritsshmërive sociale/ përshtatjes) në një mënyrë graduale përshtatjeje për të fituar një identitet të ekuilibruar.¹⁴ Në këtë aspekt, teknologjitë virtuale të komunikimit të trashëgimisë kulturore po zënë gjithnjë e më tepër një vend të rëndësishëm për transmetimin e trashëgimisë kulturore. Të virtualizosh trashëgiminë do të thotë të aktualizosh përmbajtjen e trashëgimisë në mënyrë dixhitale dhe ta simulosh atë duke përdorur teknologjinë grafike kompjuterike. Karakteristikat e “trashëgimisë virtuale” përfshijnë lehtësimin e sintezës, ruajtjes, riprodhimit, përfaqësimit, ripërpunimit dixhital dhe shfaqjes së trashëgimisë kulturore duke përdorur përparimet e teknologjisë së realitetit virtual.¹⁵

Për shkak të pajisjeve kompjuterike të avancuara dhe kartave grafike të nivelit të lartë, tendencat aktuale në aplikacionet e realitetit virtual janë të prirura drejt përdorimit të teknologjisë gjithëpërfshirëse për ndërveprim në kohë reale me detaje të imta.

Disa nga avantazhet që Realiteti Virtual i jep trashëgimisë kulturore përfshijnë:

- Dokumentimin, regjistrimin dhe ruajtjen e trashëgimisë ndërkombëtare në të gjithë botën.
- Rimëkëmbjen virtuale të trashëgimisë së humbur.
- Asistimin në procesin e arsimimit për studentët, veçanërisht ata të arkitekturës dhe transferimin e tyre virtualisht në një botë tjetër, çka i bën ata të ndihen sikur janë duke ecur në të kaluarën.
- Zhvillimin e një biblioteke të pasur për arkitektët, për t'i ndihmuar ata në restaurimin e vendeve historike.

¹³ Matthias R., Susanne H. (2017): Communication Model for Built Heritage Assets Going from Knowing to Identification (2017), World Heritage Coordination, Regensburg, Germany.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ R. M. Reffat, E. M. Nofal (2013), Effective communication with cultural heritage using virtual technologies, në “International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences”, Volume XL5/W2.

- Përhapjen e kulturës, trashëgimisë dhe traditës vendase të cilat kontribuojnë në tërheqjen e turistëve në vend. (El-Razaz, 2007)¹⁶

Aktualisht, kombinimi i trashëgimisë kulturore dhe realitetit virtual është bërë një prirje kryesore. Ai jo vetëm që mund të zgjidhë kontradiktën që ekziston për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por ka edhe avantazhe të pakrahasueshme në përhapjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Në sfondin e përshpejtimit të globalizimit dhe modernizimit ekonomik, mbrojtja e trashëgimisë kulturore përballët me shumë sfida. Elementet e trashëgimisë kulturore preken lehtësisht nga forca natyrore dhe njerëzore. Investimet për mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore janë të kufizuara. Kombinimi i teknologjisë së Realitetit Virtual dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore mund të çojë në shfaqjen e trashëgimisë kulturore me precizion të lartë, në shkallë të gjerë, interaktive dhe me audiencë të gjerë, të tillë si ruajtja dixhitale, restaurimi virtual, shfaqja e publicitetit, shfletimi virtual, muzeu dixhital e kështu me radhë, në mënyrë që të realizohet zgjidhja e problemeve tradicionale në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kjo është e favorshme jo vetëm për mbrojtjen e relikteve kulturore dhe vendeve historike, por edhe për të rritur mundësitë e prezantimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerën ekonomike dhe kulturore të saj.¹⁷ Realiteti virtual shpesh përkufizohet në termat e harduerit teknologjik që krijon dimensione të përvojës, duke ofruar nivele të ndryshme gjallërie dhe ndërveprimi në një mjedis gjithëpërfshirës ose pothuajse realist, duke sjellë iluzionin tek shikuesi të zhytjes në ndërveprimin njeri-kompjuter. Teknologjia e realitetit virtual vepron në sistemin e perceptimit të njeriut nëpërmjet kompjuterit dhe teknologjive të komunikimit, duke i lejuar njerëzit të hyjnë plotësisht dhe të ndërveprojnë me botën virtuale. Kjo i lejon njerëzit të kenë iluzionin e tejkalimit të kufizimeve të kohës dhe hapësirës dhe kufizimeve materiale.

¹⁶ Bayt al-Razzaz (2007), The challenge of adaptive use for a vacant mamluk palace in Cairo, në “International Journal of Heritage Studies”, Volumi 3.

¹⁷ Pei J. & Yi L. (2022): Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination, në “Telematics and Informatics Reports”, Volumi 8.

Modelet e hershme të realitetit virtual mbështeteshin shumë në syrin dhe dorën e njeriut për të krijuar një ndjenjë pranë në hapësirën virtuale. Me shfaqjen e mediave dixhitale, komunikimi interaktiv është rritur në bazë të komunikimit të përqëndruar. Kjo mënyrë transmetimi nuk është njëkahëshe, por e dyanshme dhe mund të shndërrohet në njëra-tjetrën. Audienca, si marrës i përmbajtjes, krijon në të njëjtën kohë përmbajtjen, e cila është komunikim ndërveprues. Integrimi i mediave dixhitale interaktive dhe botës reale i bën njerëzit të hyjnë në një hapësirë komunikimi ku media është e kudogjendur, e gjithëfuqishme dhe e gjithëpranishme.

Në këtë skenar, interneti nuk është vetëm një mënyrë ndërveprimi, por ndikon edhe në ndërveprimin e njerëzve-kompjuter me realitetin.¹⁸ Kur audienca futet në trashëgiminë kulturore virtuale, ajo do të ketë një ndjenjë më të thellë dhe më intuitive të sharmit artistik të trashëgimisë kulturore. Kultura njerëzore dhe aktivitetet e të menduarit çlirohen nga teknologjia dixhitale e informacionit dhe shndërrohen në mënyra të dukshme praktike operacionale. Kultura virtuale e sjelljes lejon një gjendje më fleksibël të ndërveprimit midis vetë subjekteve dhe midis subjekteve dhe objekteve, dhe një përvojë estetike më të pasur dhe më të larmishme të trashëgimisë kulturore.¹⁹

Si përfundim, edhe pse ekzistenca e trashëgimisë kulturore është një domosdoshmëri, si element i identitetit kombëtar, nëse ajo nuk transmetohet siç duhet, vlerat e saj humbasin dhe zhysen në harresën e kohës. Për këtë arsye nevojitet një perceptim i saktë i elementeve materiale dhe jo-materiale të trashëgimisë kulturore, i ndërthurrur nga interpretimi i duhur dhe komunikimi e prezantimi i saj me profesionalizëm, duke shfrytëzuar, jo vetëm burimet dhe njohuritë e trashëgimisë kulturore, por edhe mjetet e transmetimit të saj, si dhe duke vënë në përdorim teknologjinë bashkëkohore virtuale, si një mjet i përhapjes së gjerë të trashëgimisë kulturore dhe si një mënyrë e mbrojtjes së vazhdueshme të vlerave të saj.

BIBLIOGRAFIA

¹⁸ Po aty

¹⁹ Pei J. & Yi L. (2022): Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination, në "Telematics and Informatics Reports", Volumi 8.

- CHRISTIAN B., THIERRY J. & ISABELLE L. (2006) *Cultural Heritage and Local Development*, Bastianelli, Francë. Merleau-Ponty M., (2012), *Phenomenology of Perception*, Routledge, UK.
- DIMAGGIO, P. (1997), *Culture and Cognition*, në “*Annual Review of Sociology*”, Volumi 23, fq. 263–287. Robert L. Goldstone, Alan Kersten, Paulo F. Carvalho (2018), *Concepts and Categorization*, në “*Handbook of Psychology*”, botimi i dytë.
- ICOMOS (2008), *Interpretation and presentation of cultural Heritage Sites*, Québec.
- ANDERS HÖGBERG (2016), Rodney Harrison: *Heritage. Critical Approaches*, Routledge, Londër.
- VIVIEN B. (2015), *Social Constructionism*, botimi i tretë, Routledge, Londër.
- Matthias R., Susanne H. (2017): *Communication Model for Built Heritage Assets Going from Knowing to Identification* (2017), World Heritage Coordination, Regensburg, Germany.
- PEI J. & YI L. (2022): *Fluid space: Digitalization of cultural heritage and its media dissemination*, në “*Telematics and Informatics Reports*”, Volumi 8.
- UNWTO (2011), *Communicating Heritage – A Handbook for the Tourism Sector*, World Tourism Organization, Madrid, Spanjë.
- ALBERT B. (2010), *Reality and Technology*, në “*Cambridge Journal of Economics*”, Volumi 34, Faqja 27-35. R. M. Reffat, E. M. Nofal (2013), *Effective communication with cultural heritage using virtual technologies*, në “*International Archives of the Photogrammetry, Remote Sensing and Spatial Information Sciences*”, Volume XL-5/W2.
- BAYT AL-RAZZAZ (2007), *The challenge of adaptive use for a vacant mamluk palace in Cairo*, në “*International Journal of Heritage Studies*”, Volumi 3.

KOMUNIKIMI NDERKULTUROR MIDIS VENECIES DHE SHQIPËRISË NË MESJETË NËPËRMJET TREGTISË

Dr. IRENA NDREU

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
irena.ndreu@unitir.edu.al

ABSTRACT

My research work is of an historic and cultural character and it focuses on the venetian trade links with Albania. Since the Medieval Times, Venice had become very rich due to its trade control with Levante and its coastal line in the Adriatic Ocean and elsewhere. It was actually well-organized at the institutional and trade level, and many indications of oriental culture were present in the artistic, architectonic, and even gastronomic area, such as: different spices, which give the city its reputation as the first marine trade city. Around one hundred and thirty christian, turkish and albanian (from the city of Shkodra) trade enterprises, were kept active in the venetian city. At that time Venice competed through the production of fabrics, woollen hats, where wool was imported from Shkodra to the rest of Italy and was used in the production of mattresses and other silk manufacture. Trade exchanges between Shkodra and Venice, contributed to the economic growth of these two countries, and according to different sources it has been referred to as the golden age. But from different research works, these riches between these two countries gradually started to be reduced.

Keywords: Venice, Albania, trade, exchanges, problems.

Frut paqeje: me një shprehje të tillë sugjestionuese Giovanni Grevembrok shoqëronte imazhin e tregtarëve shqiptarë në Venecia në repertorin e tij të çmuar të jetës dhe zakoneve, ruajtur në dorëshkrimin pranë muzeumit Correr të Venecias. (NADIN: 1995)

Në atë kohë tregtarët shqiptarë ishin shtetas të shtëpisë otomane dhe përbënin ndërmjetësin në tregtinë e Venecias me Lindjen: në Venecia prania e tyre ishte e vazhdueshme dhe në San Marco në veçanti, kujton Grevembrok, ishte e pamundur të mos ndalonin, sidomos përballë

mozaikëve të bazilikatës që aludonin “ceremoni dhe vegla orientale”. Edhe prania e tyre ishte sigurisht fryt i asaj peme të politikës veneciane me rrënjë shekullore, që kishte bërë të bashkëjetonin në qytetin pazar, në qytetin udhëkryq të tregtisë, të gjuhëve të racave zakone nga më të ndryshme, duke siguruar një bashkëjetesë paqësore midis çifutëve dhe Armenëve, Gjermanëve dhe Grekëve, Dalmatëve dhe Persianëve.

Venecianët përshkonin detin për të gjetur fitime, edhe deri në fillimet 1400, burime që nuk mund të ofronte pasiguria e tipografisë lagunare. Qëllimi kryesor i politikës veneciane në vendet e Jug-lindjes europiane, të pasur me drithëra, verëra, vaj, dru dhe metal, ishte të mbante dhe ruante hyrjen e lirë me këto terriore kaq të çmuara. (MAGGIOR CONSIGLIO, Magnus, c. 13v, 1300.).

Tregtia dhe qarkullimi ashtu si dhe në shekullin XIV në Arbëri zotëroheshin nga të huajt, nga venedikasit.

Por Arbëria Venedike duke pasur marrëdhënie të vazhdueshme tregtare me venedikasit nuk përbënte një hapësirë të mbyllur ekonomike që frekuentohej vetëm nga këta tregtarë lagunarë. Kjo provincë ishte më tepër pjesë e një hapësire ekonomike që shtrihej nga grykat e Kotorit deri ne Gjirin e Patras, e që kishte si porte kryesore Kotorin, Shën Shirgjin, Lezhën, Durrësin, Vlorën, Artën dhe Vonicën. (SCHMITT: 2007) Ajo frekuentohej gjithashtu nga raguzanët dhe sidomos nga fiorentinët; në një masë më të vogël nga tregtarë të tjerë italianë.

Në shekullin e XV venedikasit dhe osmanët përcaktuan në thelb ecurinë e tregtisë arbëreshe. Kështu në fillim të këtij shekulli në Arbëri të veriut zotëronte monopoli venedikas. Ky shtet u përpoq qysh me marrjen e qyteteve arbëre që t’i lidhte ato në qerthullin ekonomik venedikas; ishte e natyrshme që tregtarët venedikas të josheshin nga mundësitë e reja në Arbëri dhe të krijonin për tregtinë venedike në Arbëri, kushte më të mira për qytetarët venedikas sesa në shekullin e XIV, në kohën e princërve të vegjël e të paqëndrueshëm të Arbërisë.

Rreth vitit 1400 nën sundimet e reja të Sinjorisë, tregtarët venedikas filluan të ndjekin gjurmët e bashkëatdhetarëve të tyre, të cilët kishin bërë tregti me Arbërinë edhe në kohët e mëparshme. Ata sillnin në Arbëri stofra italiane, dhe merrnin në shkëmbin drithë dhe kripë. Kështu Nicolo Giustinian solli në vitin 1430 në Venedik një “magnam

quantitatem frumenti". Në vitin 1424 Catarina Baffo kishte blerë në Venedik për 45 dukate drithë "dal zustignan".

Strategjinë tregtare venedikase e përshkruan në mënyrë domethënëse porosia që i jep tregtari Jacobo Faxolo përfaqësuesit të tij në Arbëri: "ia Albania ivestisse in formenti ouer altre merchandtie".

Mallra të tjera si lënda drusore, mishi pastërma, putarga dhe vera thuajse nuk shfaqen në burimet. Materialin regjës për manifakturën e tekstilit, e furnizonte Arbëria e jugut, por jo veriu venedik. Nuk ndryshoi asgjë gjatë gjithë sundimit venedik në këmbimin e thjeshtë të produkteve të gatshme me prodhimet bujqësore.

Nga burimet del se lundrimi privat me anije, ndonëse më pak i dukshëm rishte po aq i rëndësishëm sa sipërmarrjet. Tregtarët venedikas që merrnin pjesë në to përdornin strategji të ndryshme. Kështu disa tregtarë venedikas i zhvillonin lidhjet e tyre tregtare me Arbërinë nëpërmjet Kotorit dhe Korfuzit, pa shkuar vetë në Arbëri.

Ndër shkëmbimet kryesore midis këtyre dy vendeve ishte dhe tregtia e drithërave dhe e kripës.

Durrësi zotëronte portin më të mirë të Arbërisë dhe shumë fortifikime; si sundimi i vetëm venedik në Arbëri të mesme ai ishte tregu i natyrshëm për drithin e zotërve arbër aq të lakmueshëm nga ultësirat e Arbërisë së ulët. Mundësia e fitimit në tregtinë e drithit ishte kaq tunduese sa që tregtarët venedikas vinin në këtë port me gjithë rreziqet e mundshme. Edhe pse është e pamohueshme rënia e dalëngadaltë e Durrësit përgjatë shekullit XV, do të ishte gabim po të flitej për një shkatërrim të tregtisë; Durrësi varej fort nga marrëdhënia venedike-osmane; si "qytet fronti" ai e ndiente i pari krizën politike midis dy fuqive të mëdha.

Tregtarët venedikas e paguanin drithin e Arbërisë jo vetëm me para në dorë por përpiqen të ndërpusin në biznes edhe produkte të vetat si stof ose sapun. Nuk zgjedhin si vend të tregtisë vetëm Arbërinë Venedike por përfshijnë aty edhe sanxhakun osman në jug të hapësirës arbëre. Venediku, së paku në gjysmën e parë të shekullit 15, i mbajti me sa duket edhe në kohë të vështira pozicionet e veta në Vlorë, të ngritura nga Contarini në shekullin XIV. Blerës, transportues e ndërmjetës dalin qartë nëpërmjet dokumenteve; prodhuesit dhe shitësit, pra, ana arbëre e biznesit, mund të rrokët vetëm në vija të trasha. Kjo dëshmon se në

kontaktet e tyre me ofruesit arbër, tregtarët venedikas mbështeteshin kryesisht mbi ndërmjetës vendas, shpesh hebrej dhe grekë, të cilët e mbajtën gjallë tregtinë edhe gjatë luftërave midis Venedikut dhe Perandorisë osmane. (SCHMITT: 2007)

Krejt ndryshe paraqitej gjendja në Arbëri të jugut: aty mbisundonte qartë elementi raguzan, sidomos pasi osmanët morën Vlorën. Tregtarët raguzanë sillnin stofra dhe blinin drithë, kripë, peshk, pastërma, lëndë regjëse e deri dhe indigo për të mbuluar nevojat raguzane. Ashtu sikurse venedikasit në veri, raguzanët përpiqeshin në jug të hapësirës arbëre të ngrinin një monopol të kripës, çka edhe e arritën në një masë të madhe.

Megjithatë fakti që karvanët e rrihnin Arbërinë e veriut edhe në kohë krizash, flet për një vijimësi mbresëlënëse të shkëmbimit rajonal të mallrave, i cili kënaqte nevojat e banorëve të malësisë që vareshin shumë nga furnizimi me kripë e drithë prej Arbërisë së ulët. Dihet shumë pak për produktet që sillnin në bregdet karvanët. Sido që të ishte, tregtia me metale, para së gjithash me plumb, të cilin e blinin venedikas, raguzanë dhe fiorentinë në Lezhë, kishte rëndësi të kufizuar.

Por përveç tregtisë që venedikasit bënë në Shqipëri e rëndësishme ishte edhe tregtia që shqiptarët bënë në Venedik.

Një vend të rëndësishëm zinin tekstilet e lidhur kjo me industrinë e lulëzuar të leshit në Venecia; prodhuesit e beretave: mjaft intensivë që tregtia që tregtarët shqiptarë, prodhues të beretave, bënë me Bosnjën, Greqinë dhe Dalmacinë. e Molmeti tërheq vëmendjen se akoma në 800-ën mund të shiheshin shumë shqiptarë duke shitur nëpër rrugët e Venecias beretat e tyre me nam; madje përmend edhe emrin e shitësit të fundit shqiptar, një farë Marco Pena, dhe lokalizon tregtinë e trashëgimtarëve të tij në një shtëpi në afërsi të San Giacomo dall’Orio, dhe përveç këtyre edhe prodhuesit e qivureve.

Un provvedimento davvero innovativo prevede che qualsiasi straniero naturalizzato cittadino veneziano potrà lavorare le “veluta, camoca, panni damasceni, brocati, et cuiscumque sortis laboreria sete auri et sete argente cuiscumque latitudinis mensura...” (SENATO MISTI, Reg. 48, c. 15v, 1410)

Që nga viti 1350, Konsujt e tregtarëve nuk e gjykonin të domosdoshme të rrisnin numrin e artizanëve. (CONSOLI DEI MERCANTI, Capitolare, b. 55, 1350. MAGGIOR CONSIGLIO, Novella, c.5.)

Tani deri në atë kohë, të huajt nuk kishin të drejtë të ushtronin disa zanate ose të paktën (COMUNE, I, c.143, 1251-1382) duhej, para se të përdornin disa materialeve të caktuara, të kërkonin lejen e qeverisë. Për të tërhequr artizanët, një vendim i Konsujve të Tregtarëve vendosi në 1358 se “çdo mjeshtër person ose nxënës i të dy gjinive, që dëshiron të vijë në Venecia për t'u bashkuar me një trup të zanateve mund ta bënte pa paguar asgjë, si dhe ata që ishin të vendosur tashmë në «Venecia». Përveç shumë marinarëve nuk mungonin tregtarë stofi, muratorë, argjendarë, prodhues kordelesh, skalitës guri, teknikë për matjen e vëllimit të varkave, dhe akoma berberë dhe furrtarë.

Gjithashtu në Venecia numëroheshin shumë shqiptarë mjeshtër të xhamit, siç është dëshmia e fundit të 400-ës e Nicolo di Biagio, shqiptar në Murano, i cili vazhdonte si me thënë suksesin e fabrikës së xhamit “Alla Pigna” që drejtohej pikërisht nga një familje shqiptare që nga dekadat e para të 400-ës; si dhe tregtarë shqiptarë shumë aktivë në tregtinë e vajit. (NADIN:1995)

Nga kërkimet e bëra mësojmë se nga marrëdhëniet tregtare që Venecia ka pasur që në kohën e Republikës, me Shqipërinë, kanë qenë themeluar në Venedik rreth njëqind e tridhjetë kompani tregtare të krishtera, turke dhe shqiptare nga qyteti i Shkodrës, të cilat me shkëmbimin e prodhimeve ndërmjet këtyre vendeve, ruanin aktiv dhe fitimprurëse tregun.

Lëvizja vjetore e këtij tregu, prodhonte vlerën e rreth 100,000,000 *lira veneto* siç provohej atëherë nga statistikat konsullore dhe doganore.

Në atë kohë Venecia shkëlqente në prodhimin e pëlhurave dhe kapelave të leshta që përdorehin në Levante, kadife, brokadë si dhe prodhime të tjera të mëndafshit; shkëlqente gjithashtu në prodhimet e shumta dhe të ndryshme të industrisë indigjene.

Ndërkohë përveç tregtisë së materialeve dhe tekstileve të ndryshme mund të themi se një vend të veçantë gjatë gjithë kësaj periudhe zuri edhe tregtia me arratiakët shqiptarë drejt brigjeve të Italisë dhe në veçanti drejt Venedikut. Për disa funksionarë mjerimi i arratiakëve ishte

një mundësi e shkëlqyer për fitim. Autoritete të korruptuara punonin krah për krah me trafikantët: arkëtari i Lezhës arriti të kalonte rreth 10.000 refugjatë nëpërmjet portit të Durrësit; prej secilit ai mori nga dy groshë, pavarësisht nëse udhëtimi shkonte për në Venedik ose drejt Pulias. Nxirrnin gjithashtu fitim prej mjerimit edhe kapitenët e anijeve të vogla tregtare: njihen prej dosjeve gjyqësore emrat e disave, si për shembull Polo Luzia, i cili pruri në dy udhëtime 150 arbër në Itali; Stefani prej Lezhe dhe pronari i anijeve Piero Bianco, që transportuan 100 refugjatë; Latoty, i cili transportoi për në Venedik 150 arbër për një groshë. Por megjithatë nuk kishte shumë anije dhe çmimi për një udhëtim u ngjit në tre lira *di piçojl* për person. (SCHMITT: 2007)

Siç u përmend edhe më lart pjesët e importuara në Venedik ishin nga më të ndryshmet, si prodhimet prej leshi të Shkodrës, në ditët e sotme të njohura në gjithë Italinë për përdorimin e tyre në dyshekë, tjetër lloj leshi më fin, për përdorimin e fabrikave, qirinj, lëkurë lepurit dhe të llojeve të ndryshme kafshësh, mëndafsh i përpunuar dhe shumë artikuj të ndryshëm të prodhimit shqiptar; dhe në fund importimet më të shquara që binin më shumë në sy ishin shumat e parave në flori dhe argjend, kështu kishte ngelur proverbiale sasia e madhe e monedhave veneto që në atë kohë silleshin nga Shkodra në Venecia. Tregtari i pasur turko-shkodran, Roi, nuk nisej nga vendi i tij për të hyrë në Venecia, ku brenda 6 muajsh përmbushte xhiron e tij të pazareve dhe sillte përveç sasive të mëdha të mallrave të ndryshme, pa shumën e spikatur e njëqindmijë zecchini dukati. Kështu shitësi tjetër i pasur dhe i krishterë, Melgusci, gjithashtu nga Shkodra, gjashtëdhjetëmijë; dhe pastaj vinin të tjerë, me shuma më të vogla. Kjo quhej, për të dy vendet, edhe koha e floririt.

Fatkeqësisht, ky treg që sillte njëherësh shumë fitime në sheshin e Venecias, pakësonte gradualisht pasurinë e Shqipërisë, por marrëdhëniet tregtare kanë vazhduar deri në ditët e sotme.

Sidoqoftë, ne duhet të kujtojmë se Venecia donte të ishte pronar dominues i brigjeve dalmate dhe shqiptare, për arsye të dukshme strategjike që lidhen me politikën e saj ekonomike, pra shkaqet e shtrirjeve veneciane, në shekullin e katërmëdhjetë janë motivuar nga shkaqe të rendit ekonomik (THIRIET, 1968).

BIBLIOGRAFIA

- BETTINI SERGIO, (1933) *Orme d'Italia e di Venezia nell'alta Albania*, in "Rivista di Venezia" XII
- CONSOLI DEI MERCANTI, Capitolare, b. 55, 1350. MAGGIOR CONSIGLIO, Novella, c.5.
- COMUNE, I, c.143, 1251-1382 "Quod nullus forensis sit passator".
- F. THIRIET, (1968), Quelques réflexions sur les entreprises vénitiennes dans les pays du Sud-Est Européen, "R.E.S.E.E.", 3, (395-400).
- G. FEDALTO, (1977) *Le minoranze straniere a Venezia tra politica e legislazione* Firenze.
- L. NADIN, (1995) *Venezia e Albania: tracce di antichi legami* Agfol (3).
- G. FEDALTO, (1967) *Ricerche storiche sulla posizione giuridica ed ecclesiastica dei greci a Venezia nei secoli XV e XVI*, Firenze
- O. SCHMITT, (2007) *Arbëria Venedike 1392 – 1479 shqip nga Ardian Klosi* Tiranë (556).
- SENATO MISTI, Reg. 48, c. 15v, 1410. MAGGIOR CONSIGLIO, Magnus, c. 13v, 1300.
- L. NADIN (2008) *Migrazioni e integrazione: il caso degli albanesi a Venezia (1479-1552)*, Roma, Bulzoni.

ASPEKTET SOCIO-PSIKOLOGJIKE MES GJUHËS DHE KULTURËS NË KONTEKSTIN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GJERMANE NË SHQIPËRI

Dr. ERGYS PRIFTI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ergys.prifti@unitir.edu.al

Msc. ELFRIDA BILAJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

This presentation intends to show to German learners, future German teachers etc. some fundamental didactic problems which we consider to be important fields of action in teaching and learning the German language. Here we cover some problems from different linguistic areas such as phonetics, spelling, grammar, lexicology, etc. Practical solutions are also suggested for several problems.

Keywords: Pedagogy, German language, Albanian language, learning, preparation, psychology, grammar, articulation, understanding, spelling, emphasis, scientific truth

Kjo kumtesë është një përpjekje për të shtruar disa probleme themelore didaktike për nxënësit dhe studentët, mësuesit e nesërm të gjuhës gjermane, probleme të cilat mendojmë se përbëjnë fusha të rëndësishme të veprimtarisë në mësimdhënien e nxënien e gjuhës gjermane.

Mësimdhënia e gjuhëve të huaja, si pjesë e të mësuarit, është objekt i drejtpërdrejtë i didaktikës në përgjithësi dhe i metodikës në veçanti, duke shkuar drejt orientimit të procedurave didaktike në procesin mësimor.

Parimet themelore didaktike, si orientime shumë të rëndësishme për t'u zbatuar, kanë fushë të plotë veprimi për mësuesit dhe pedagogët, që punojnë në të gjithë kategoritë e institucioneve arsimore me nxënës të moshave të ndryshme por edhe me studentë, të cilët janë përqëndruar në mësimin e gjuhës gjermane.

Shtrirja e sotme e të mësuarit të gjuhës gjermane premtan për një zgjerim të shpejtë e të mëtejshëm të saj në mbarë hapësirat shqiptare, drejt dy- dhe trefishimit të institucioneve e kontingjenteve që e ndjekin.

Vendi që zë gjuha gjermane në planin mësimor të gjimnazëve me orientim gjuhësor, është shumë i rëndësishëm për faktin se çdo ditë zhvillohen rreth një orë mësimi në këtë gjuhë. Por edhe në shkollat tjetra, ku është shtrirë të mësuarit e saj, ajo është vlerësuar si lëndë.

Mësimi i gjuhës gjermane në këto gjimnaze vjen pas një përgatitjeje teorike e praktike në gjuhën amtare të kryer në shkollën 9-vjeçare, por kryesisht fillestar në njohuritë e gjuhës gjermane.

Edhe formimi letrar është i ndryshëm sa i përket njohjes së letërsisë gjermane, një domosdoshmëri për formimin e përgjithshëm të nxënësve e studentëve, që mësojnë këtë gjuhë.

Pra, problemi i vijimësisë në të mësuar nuk qëndron, por disi më i zbutur është në fakultet në kontingjentin e atyre studentëve, që kanë njohuritë e nevojshme në gjuhën gjermane.

Kuptohet se diferencat cilësore, sidomos vitin e parë, edhe në fakultete qëndrojnë, por shkojnë drejt zbutjes e shkrirjes në vitet e dyta dhe të treta.

Vetë mësimi i gjuhës së huaj ndikon edhe në njohjen e gjuhës amtare, siç ka ndikuar më parë kjo në njohjen e gramatikës e të gjuhës së huaj në përgjithësi, jo vetëm nga fakti se gjuha është e fondit indoeuropian por edhe për faktorë të tjerë.

Pra edhe gjuha e huaj ndikon për mirë dhe e bën më të lehtë, më elastike e shprehëse edhe gjuhën amtare.

Përpara se të grupojmë drejtimet themelore didaktike dhe synimet tona në këtë fushë, po përmendim disa vështirësi, mangësi dhe dobësi

në njohuritë e nxënësve dhe studentëve që mësojnë gjermanisht, të cilat i kemi konstatuar edhe në anketimet e zhvilluara me nxënës dhe studentë.

Disa prej këtyre problemeve janë më afatgjata:

1. fjalor i kufizuar në gjuhën gjermane. Kuptohet që është e vështirë të realizohet procesi i të folurit, që është aspekti më i vështirë, i ligjërimit dhe ku kombinohen dijet gjuhësore me aftësitë për t'i përdorur sipas situatave konkrete, pa pasur një fjalor të pasur;

2. theksimi dhe artikulimi i drejtë dhe i saktë i fjalëve dhe fjalive në gjuhën gjermane

3. vështirësi në aplikimin e rregullave të reja drejtshkimore, (të cilat janë vendosur në vitin 1994) , por akoma jo të qarta për disa nxënës dhe student;

4. në ndërtimin e fjalive ka vështirësi në renditjen e gjymtyrëve të fjalisë, sidomos në fjalitë e nënrenditura me kallëzues të përbërë;

5. përdorimi i foljeve të parregullta dhe formimi i kohëve gramatikore të tyre;

6. përdorimi i parafjalëve të duhura dhe rasa, e cila i shoqëron ato;

7. aplikim më i gjerë i ushtrimeve fonetike;

8. zhveshja nga emocionet në gjuhën e folur, e cila mund të kapërcehet me më tepër bashkëbisedim në gjermanisht me nxënësit gjatë orës së mësimi, sidomos në vitet e para të shkollës së mesme apo të fakultetit;

9. mjedisi gjuhësor i varfër ndikon gjithashtu negativisht dhe i rrit vështirësitë në punën për të mësuarit e gjuhës gjermane;

10. përgatitja psikologjike e nxënësve, veçanërisht në vitet e para, për t'u ambjentuar me tingëllimin dhe theksin në gjuhën gjermane, veçanërisht në dhjetë ditët ose dy javët e para të mësimi të gjuhës;

11. pasurimi i brendisë së të mësuarit, jo vetëm me tekste standarte e vetëm me gjuhën e tekstit, por edhe të komunikuarit me tekste me përmbajtje shoqërore e zyrtare, p.sh. tipe letrash shoqërore, aktesh zyrtare, korrespondencë etj;

E rëndësishme është që njohuritë që jepen për gjuhën gjermane, të kenë vërtetësi shkencore. Kjo është një nga kërkesat didaktike

themelore, madje kryesorja për mësimdhënien dhe të mësuarit e gjuhës së huaj.

Ky parim do të thotë, që mësimi të zhvillohet me nivel shkencor, pa gabime, informacioni që jepet të jetë i vërtetuar për vërtetësinë e tij, gjuha që përdoret në mësim të jetë konform kërkesave të gjuhës letrare, e jo një e folme dialektore apo krahinore, duke pasqyruar, kështu, gjuhën bashkëkohore.

Duhet të përdoren materiale të botuara në vitet e fundit.

Tendenca për t'i dhënë shumë informacion nxënësit, e cila vërehet tek disa mësues, krijon mbingarkesë, atakon dhe nuk është në përputhje me parimin didaktik *të marrjes në konsideratë të gradualitetit*.

Në zhvillimin e njohurive që janë përcaktuar në program, vihen re në disa raste përpjekje për t'i dhënë nxënësit pjesën më të madhe të njohurive, nuanca të holla gramatikore, kërkohet një shqiptim i përsosur si dhe një njohje e një pjese të mirë të fjalorit.

Këto vështirësi që paraqiten në të mësuarin e gjuhës së huaj duhet të trajtohen me kujdes e me durim nga mësuesit dhe pedagogët. Ato as nuk duhen fetishizuar, as nuk duhen lënë pas dore. Nocionet gramatikore nuk rekomandohet të punohen menjëherë, por pas punimit të tekstit, duke bërë kujdes që ora e mësimit most ë zihet vetëm me rregulla gramatikore. Sigurisht që merren në konsideratë edhe rastet e shumta të përjashtimeve, të cilat gjithashtu përbëjnë “rregulla më vete”. Edhe këto njohuri zhvillohen në mënyrë graduale.

Në këtë kuadër është i rëndësishëm përvetësimi i bazave të gjuhës, që ka të bëjë me elementet fillestare gjuhësore.

- Në fazën e parë të të mësuarit të gjuhës gjermane është e nevojshme të jepen më pak njohuri gramatikore, të cilat mund të zhvillohen disi më vonë, mbi *bazën e gradualitetit të dhënies së njohurive* dhe të vazhdimësisë së tyre.

Dhënia e njohurive sipas një sistemi dhe vijimësie logjike është bazë për të rritur rendimentin e kohës mësimore në dispozicin. Ky është një problem jo vetëm për grupet e kurrikulës, për ato që hartojnë programet dhe tekstet mësimore, por është po kaq i mprehtë edhe për mësuesit dhe pedagogët në tërë etapat e orës së mësimit në gjuhën

gjermane. Që në bisedat e para duhet bërë kujdes që njohuritë të jenë një rrjedhë logjike në vazhdimësi.

Kjo është e lidhur edhe me të nxënit nga ana e nxënësve dhe studentëve, zhvillimi tek ata i aftësive të tyre për të punuar sistematikisht e në mënyrë të pavarur.

Pra, kur themi që të përpiqemi për përvetësimin e bazave të gjuhës, ne kemi parasysh përvetësimin e asaj që është më e domosdoshme dhe që qëndron në themel të gjuhës.

- Një problem madhor në fushën e didaktikës për gjuhën gjermane është dhe **lidhja e teorisë me praktikën**, aftësimi praktik i të folurit e të shkruarit të nxënësve. Kjo lidhet me aplikimin e ushtrimeve gjuhësore, me analiza teksti, të filmave të ndryshëm, me bashkëbisedime të lira, të cilat qartësojnë problemet e lëndës, të ushtruarit e nxënësve dhe të studentëve në të kuptuarit e gjuhës së shkruar e asaj të folur në procesin e ligjërimit.

Në këtë kuadër trajtohen edhe probleme të përgjithshme që synojnë në aftësimin e nxënësve dhe të studentëve në ushtrimin praktik të gjuhës.

- Kështu, duke parë ose interpretuar filma e tekste të ndryshëm, lehtësohet puna me fjalorin, krijohen situata që kërkojnë diskutim të lirë, të cilat nxitin imagjinatën e nxënësve dhe të studentëve, duke gjallëruar aktivizimin e tyre.
- Bashkëbisedimi në këto raste është interesant. Si në të gjitha fushat e gjuhësisë, të gjuhës amtare ose të gjuhëve të huaja, duke individualizuar gjuhën gjermane, ka vlera të mëdha uniteti mes tyre (gjermanisht-shqip), duke e kuptuar si domosdoshmëri të pashmangshme kalimin në njëanshmëri.
- Për lidhjen e teorisë me praktikën luan një rol të veçantë laboratorit i gjuhës së huaj, sidomos kur pasurohet me fond të pasur ushtrimesh fonetike, të cilat përmbledhim vështirësitë tipike që u dalin nxënësve e studentëve në shqiptimin e gjuhës gjermane.
- Gjuha gjermane ushtrohet nga mësuesit dhe nxënësit, duke zbatuar edhe parimin didaktik të ekonomizimit në gjithçka.

Kjo do të thotë:

- kursimi në kohën materiale, duke e ruajtur e shfrytëzuar atë me efikasitet të lartë;
- shfrytëzimi me efikasitet i çdo etape në orën e mësimit, duke kursyer kohën materiale në hapat metodike, duke krijuar situata të qarta e të kapshme nga nxënësit, në mënyrë që të mos humbet kohë për të kuptuar situata të paqarta në orën e mësimit;
- evitimi në maksimum i ushtrimeve të mërzitshme, të cilat nuk aktivizojnë klasën, masën e nxënësve.

Në zbatim të këtij parimi themelor të didaktikës është me vlerë edhe ekonomizimi i literaturës së përdorur, zgjedhja cilësore e së cilës çon direkt në konceptet bazë, që të jep shkurt e qartë përgjigjen e kërkuar, ose të çon në rrugët e dhënies së përgjigjeve.

Gjuha gjermane hyn në fondin e “gjuhëve moderne”, si trajtohen aktualisht në literaturën botërore.

Të ndjekësh mësimit në këtë gjuhë, në kushtet aktuale për shqiptarët, nuk teprohet po të thuhet se është një privilegj.

Në të gjitha institucionet arsimore me mësimdhënie të gjuhës gjermane është domosdoshmëri pajisja e tyre me laboratorë, video, fjalorë të ndryshëm një- e dygjuhësh, si dhe të sigurohet letërsi e vendit, gjuha e të cilit mësohet, dmth. letërsi gjermane.

Të mësuarit dhe fillimisht, të siguruarit e letërsisë gjermane origjinale, është një kërkesë aktuale, bashkëkohore, e cila duhet të shoqërohet me mbledhjen e burimeve të tjera kulturore mbi gjuhën, historinë, gjeografinë etj.

Në literaturën pedagogjike e didaktike është shumë i njohur koncepti *“përsëritja, nëna e dijes”*. Nga ky koncept nuk shpëton as gjuha gjermane, për të cilën përsëritja, duke filluar nga ajo brenda orës mësimore, brenda kapitullit etj. është e domosdoshme, ashtu siç janë të domosdoshme ushtrimet për kujtesën, ruajtjen dhe zhvillimin e saj. Kjo lidhet me faktin se, dije të qëndrueshme kemi atëherë kur njohuritë e fituara, që mbahen mend për një kohë të gjatë, riprodhohen në mënyrë të vullnetshme.

Kjo është një kërkesë për brendinë e të mësuarit në përgjithësi, por për gjuhën e huaj, vetë specifikat e nxënies së saj, kujtesa ka rëndësi të veçantë dhe në këtë kuadër rëndësi të madhe merr edhe njohja e saj dhe mënyra e të ushtruarit për zhvillimin e mëtejshëm të kujtesës. Riprodhimi, përsëritja e lëndës duke sjellë variante apo informacione të pjesshme të reja, ose mjete mësimore që ndikojnë në konsolidimin e saj, si temë, kapitull, apo më gjerë, ndikojnë në sistemimin e njohurive, në thellimin e tyre, sidomos kur kjo shoqërohet me ushtrime dhe variante të tjera, deri tek loja gjuhësore apo mësimore. Nuk mund të ketë njohuri, shkathtësi e shprehi të thella e të qëndrueshme, pa ushtrimin e tyre, pa përsëritje.

Baza gjuhësore e nxënësve dhe e studentëve, ndonëse mund të jetë e afërt, nuk është e njëjtë. Pikërisht këto disnivele duhet t’i kapë syri i mprehtë i mësuesit dhe i pedagogut, i cili merr masa për mbulimin e mangësive në fusha të ndryshme të mësimin të gjuhës gjermane.

Kjo ka të bëjë me një parim themelor didaktik, *atë të trajtimit të diferencuar e individual të nxënësve dhe studentëve*, që do të thotë që nuk është çështje fakultative, që lihet në dëshirën e mësuesit dhe pedagogut, por është një problem parimor, i detyrueshëm për t’u zbatuar. Mënyra e zbatimit nga ana e mësuesit -ka fushën e krijimit e të origjinalitetit, në varësi të dëshirës së tij. Zhvillimi i mësimin kërkon shmangie nga verbalizimi i thatë, kërkon aplikimin e metodave audiovizuale- sidomos në përshpejtimin e të mësuarit të gjuhës së huaj.

Duhet te theksjome risinë në këto vitet e fundit -ku metodat audivizuale interaktive, janë futur dhe zbatohen gjerësisht në fakultetin tonë por edhe në disa gjimnaze, risi që duhet përgezuar – me shpresën e shtrijes edhe në institucionet e tjera arsimore. Kështu mësimi ndikon në formimin e koncepteve mbi bazën e perceptimit të drejtpërdrejtë të sendeve dhe dukurive të realitetit objektiv ose figurave të tyre.

Objektet më të cilat do të punohet nga nxënësit duhen parë, sepse janë sinjalet reale që kanë veti të ndryshme. Por edhe kjo nuk mjafton. Ato nuk perceptohen vetëm me anë të pamjes, por edhe duhen dëgjuar, prekur etj.

Zbatimi me aftësi *i parimit didaktik të konkretizimit*, që është aq i vjetër, i përcaktuar katër shekuj më parë nga pedagogu i nivelit botëror **Jan Amos Komenski** është njëkohësisht tërësisht i ri dhe

përherë aktual, edhe tani, në stadet e reja të modernizimit të procesit mësimor, pasi në mes të tjerave krijon emocione, lehtëson vëmendjen, ndihmon në të mbajturit mend të fjalëve, të shprehjeve frazeologjike, etj.

Duke zbatuar metoda audiovizuale dhe interaktive, arrihet të pajisen nxënësi apo studenti i gjermanishtes me strukturat kryesore të kësaj gjuhe, mbi bazën e një fjalori themelor. Kjo shoqërohet me një shmangie të përkthimit, të mësuarit përmendësh të rregullave gramatikore, duke nxitur përdorimin praktik të dukurive gjuhësore.

Përfundime

Në përgjithësi, në shkollat e larta mjetet audiovizuale dhe interaktive përdoren gjërësisht. Fushë përdorimi ato mund të gjejnë edhe në rastet kur duhet përshpejtuar mësimi i gjermanishtes. Kjo ndihmon në krijimin e shprehive gjuhësore bazë, në aftësimin për kuptimin e gjuhës në dëgjim, në kuptimin në shikim e dëgjim duke identifikuar përmbajtjen e çdo kuadri të paraqitur në film me dialogun, për të përvetësuar standartin e planifikuar të gjermanishtes.

Është e nevojshme njohja e mundësive për të përshkallëzuar e pasuruar më tej bazën mësimore didaktike dhe aftësimin e mësuesve dhe pedagogëve për shfrytëzimin e kësaj baze, që të mos mbetet si stoli në klasat-kabinet. Pa e fetishizuar rolin e madh të mjeteve mësimore didaktike, nënvijëzojmë rolin e madh që luajnë ato në përshpejtimin e ritmeve në mësimin e gjermanishtes, për krijimin e modeleve të qëndrueshme leksiko-gramatikore në kujtesën e nxënësit dhe nxitjen e mendimit të tij krijues për përvetësimin e gjuhës së huaj.

BIBLIOGRAFIA

- NEUNER, G / HUNFELD, H (1993): *Methoden des fremdsprachlichen Deutschunterrichts, eine Einführung*, Langenscheidt.
- DUDEN (1998), *die Grammatik*, Dudenverlag
- DIDAKTISCHES WÖRTERBUCH (2001), 3. Auflage, *Hand- und Lehrbücher der Pädagogik*, Oldenburg, Vjenë
- OSSNER, J / Zinsmeister (2014), H: *Sprachwissenschaft für das Lehramt*, Schönigh UBT, Paderborn

ARTI I RAFIGURIMIT NË ILIRI NGA SHEK. VIII - III. P. K. NË DISA OBJEKTE TË VEÇANTA (QERAMIKË DHE SKULPTURË), SI KRIJUES I ITINERAREVE TURISTIKE HISTORIKO-KULTURORE NË MUZETË EVROPIANË DHE NË ATO TË SHQIPËRISË

Msc. JANI KOÇILLARI

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
Universiteti i Tiranës,
jani.kocillari@unitir.edu.al

ABSTRACT

Antiquity objects from Epidamnos (Durrës) and Apollonia exhibited in Albanian museums represent a very special but little-known wealth of cultural heritage. They are the evidence that since antiquity there is a cultural and economic connection between Illyrian realities and Hellenic cities (poleis) such as Athens and Corinth with those of the tribes of southern Italy such as the Apuletes, the Campanians, the Lucanians and the colonies of "Magna Graecia". Special examples are not only the black and red-figure pottery of the Attic masters such as the painters Antimenes (identified), Brygos, scenes of the Amazonomachy, but also in the refiguration's of myths such as Heracles, Ulysses and Achilles. These scenes can also be found in the British Museum, the Royal Museum of Fine Arts in Brussels, the Archaeological Museum in Athens, the Cleveland Museum (USA), in Madrid and many others. The Nike of Apollonia, with the bull for the sacrifice, further emphasizes these connections. Precisely in historical sources, both in Aristotle and in the traditions of mythological foundations, many of these relationships testify. This artistic and cultural heritage is strategic for the economic development and for the culture of different areas of Albania.

Keywords: Apollonia, Culture, Cultural Heritage, Epidamnus (Durrës), European Museums, Figured Pottery, Illyria, Nike of Apollonia, Painter of Antimenes, Painter of Brygos, Tourist itineraries.

Trashëgimia kulturore shqiptare, veçanërisht artefaktet që lidhen me kontekstin historik arkeologjik, shfaqin gjetje vërtet interesante.

Objektet e antikitetit të zbuluara në Epidamnos (Durrës) edhe në Apoloni shfaqin një pasuri kulturore interesante, por që është pak e njohur.

Analiza e tyre na lejon të kuptojmë kontekstet historike dhe kulturore sidomos lidhjet ekonomike midis realiteteve ilire dhe qyteteve (polis) helene si Athina dhe Korinti me ato të fiseve të Italisë të jugut si Apulët, Kampanët, Lukanët dhe kolonive të “Magna Graecias”, të cilat përfshijnë një hark kohor nga shek. VIII. p. Kr. deri në ardhjen e Romës¹. Koleksionet muzeale evidentojnë lidhje të ndryshme. Shembujt të veçantë, por jo vetëm, janë qeramikat me figura të zeza dhe të kuqe, të mjeshtërve atikë të shek. VI p.Kr. si Antimenesi (identifikuar)², ose si piktori i Brygosit, por edhe skenat e Amazonakisë, të cilat evidentojnë marrëdhëniet ekonomike me polisin e Athinës dhe me realitetet fisnore të Italisë. Me interes janë dhe skenat e miteve si: *Herakliu*, *Uliksi* dhe *Akili*, etj., që krijojnë lidhjet me Muzeun Britanik në Londër, Muzeun Mbretëror të Arteve të Bukura, Muzeun Arkeologjik të Athinës, por edhe Muzeun e Cleveland (SHBA), Madridit në Spanjë dhe shumë të tjerë, si p.sh. Muzeun Arkeologjik të Apolonisë, ku gjejmë skenën e Nikjes që sakrifikon demin për nder të fitores. Trashëgimia artistike dhe kulturore është strategjike për krijimin e itinerareve me muzetë evropiane për të ndihmuar zhvillimin ekonomik - kulturor të disa zonave të ndryshme të Shqipërisë.

1. Pasuria e trashëgimisë kulturore nga Epidamnos (Durrës) te Apolonia dhe lidhjet me objekte të muzeve evropiane dhe ndërkombëtare

1.1. Enët me figura të zeza (shek. VIII – V p. Kr.) dhe të kuqe (shek. V – III p. Kr.) dhe rëndësia kulturore e Adriatikut

Adriatiku historikisht konsiderohet, që nga antikiteti, si një rrugë e rëndësishme komunikimi kulturor ekonomik për të gjitha realitetet

¹ KOCILLARI J. (2016), *Ceramica a figure rosse in Albania produzioni e importazioni*, ExpoVision, Tiranë.

² Buza e një dinosit me figurë të zeza.

e tij³. Ndër të cilët *ilirët, etruskët, helenët* etj. Në këto rrugë tregtare kanë lundruar mikenasit, por edhe figura mitologjike si: Argonautët, Uliksi (eubeatë vendosën në këtë det ngjarjet e Odisesë), Antenori, Diomedi, dhe fenikasit përmes mitit ilir të Kadmosit dhe Armonisë⁴. Historiani Emilio Pianezzola, duke marrë frymëzim nga Fernard Braudel, e quajti Adriatikun një “rrugë ujore” të rëndësishme⁵, e cila lidh dy brigjet duke krijuar një rrjedhë idesh të marrëdhënieve midis Lindjes dhe Perëndimit. Helenët e lashtë e quanin “Adrias”⁶ ose “Jonos”; Apoloni i Rodit në Argonatikën e tij e përcaktoi atë si “Deti i Kronusit”⁷. Në vitin 733 p. Kr. Kersikrati i Korintit mori ishullin e Korfuzit nga liburnët ku themeloi koloninë e Korcirës. Njëpërmjet marrëveshjeve me taulantët u themeluan kolonitë e Epidamnosit në vitin 627 p. Kr. dhe të Apolonisë në vitin 588 p. Kr.⁸. Me themelimin e tyre u intensifikuan importet korintike të qeramikës me figura zeza⁹, të cilat së shpejti do të zëvendësohen me ato atike, të kërkuara nga aristokracia vendase për të justifikuar autoritetin e tyre njëpërmjet lidhjeve familjare me mitin, siç është rasti i amforës së ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar, e gjetur rastësisht në vitin 1955, pjesë e inventarit të varrit të një individi të pasur. Skenat kryesore të amforës trajtojnë tematika nga *Gjigantomahia*, si dyluftimin midis Athinasë, e paraqitur në variantin Promahos, dhe gjigantit Enkelados (?), dhe një episod nga mitologjia greke, Poliksenën duke shkuar për të mbushur ujë në krua, e shoqëruar nga vëllai i saj Troilo, të dy fëmijë të Priamit, mbretit të Trojës¹⁰. Të dy skenat i referohen mitit. Sipas mitit ata po largohen nga ardhja e Akilit (i cili nuk paraqitet në këtë skenë). Kjo skenë, gjendet edhe tek amfora e British Museum dhe tek disa fragmente në arkivin e Muzeut Arkeologjik të Bolonjës, por sidomos edhe te afresket e varrezave etruske. Duke marrë parasysh formën, stilin e pikturimit dhe tematikat

³ BRACESSI L.(1971), *Le rotte commerciali*, në «Grecità Adriatica. Un capitolo della colonizzazione Greca in Occidente», f. 13.

⁴ NAVA M. L. (2004), *I Pirati e il Mare nelle Stelle Daunie*, në «Hespèria», n. 19, f. 75.

⁵ PINEZZOLA E. (2002), *Adriatico e altri mari, un immagine simbolo per la Graia Camena di Orazio*, në «Hespèria», n. 15, f. 13.

⁶ Emri i detit verior.

⁷ COPPOLA A. (2002), *I Nomi dell'Adriatico*, në «Hespèria», n. 15, f. 103.

⁸ CEKA N. (2005), *Ilirët*, Migjeni, Tiranë.

⁹ Deri në fillim të shek. VI p. Kr.

¹⁰ Zbuluar ne Apoloni shek. VI p. Kr., lartësi 43,00 cm. MANO A. (1981), *Tri vazo antike në Muzeun Arkeologjike i Tiranës*, në «Iliria», II, f. 95-97, tab. I. 1, 2, 3, 4.

e frymëzuara nga mitologjia greke të trajtuara në trupin e amforës, del e qartë se ajo është prodhuar në gjysmën e dytë të shek. VI p. Kr., nga punishtet e Atikës, që ishte qendra më e rëndësishme e prodhimeve të vazove greke në këtë periudhë. Kjo amforë me figura të zeza përbën një dëshmi me vlerë që hedh dritë mbi praninë e marrëdhënieve ekonomike midis Apolonisë së Ilirisë dhe Atikës në gjysmën e dytë të shek. VI p. Kr. Një rast i veçantë, pak i njohur, është fragmenti i dinosit i ekspozuar në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Durrësit. Një vepër që mund t'i atribuohet (siç do të shohim) mjeshtrit të Atimenesit. Këto objekte krijojnë lidhjet mes muzeve shqiptare dhe atyre evropiane.

1.2. Lidhje me objekte të muzeve evropiane dhe ndërkombëtare: *cikli i Herakliut; cikli i Amazonomakisë dhe lufta e Trojës; cikli i Uliksit*. Rasti i veçantë i piktorit/mjeshtrit **Atik Antimenesi në Epidamnos (Durrës).**

Skenat e paraqitura në qeramikën me figurë të kuqe, krijojnë ato lidhjet kulturore, si për shembull veprat e mjeshtrit të Brygosit¹¹, të cilat shfaqin perëndeshën Athinën dhe heroin Herakliun, në një pamje rinore, me lëkurën e luanit¹². Të njëjtën skenë e gjejmë të ekspozuar në Muzeun Britanik, (pjesë të zbuluara në qytetin antik etrusk të Vulcit që i atribuohet piktorit D 14¹³), si edhe në amforën me figurë të kuqe të ekspozuar në Muzeun e Luvrit (fig.1)¹⁴.



Fig.1. Herakliu me Athinën: Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Britanik, Muzeu i Luvrit

Gjendet gjithashtu e pasqyruar edhe në amforën e Universitetin Hoabart (Tasmania - Australi) dhe në Antiken Museum, Bâle në Zvicër¹⁵. Këtij konteksti i përshtatet edhe hidra e Apolonisë e shek. IV. p.Kr. me skenën e (fig.2) III° - Shpendët Stimfalikë në të cilën shohim heroin e përshkruar me kafshë mitologjike. Miti i Herakliut në këto zona është historikisht i rëndësishëm, jo vetëm për kolonët korintasit, por edhe për mitin ilir, siç shkruan Apiani, pasi lidhet me origjinën e Epidamnos-it antik. Por edhe për fisin ilir të Hyllinjve: të cilët e lidhën origjinën e tyre me Hyllin, bir i Herkulit si mbreti i tyre mitologjik¹⁶,




Fig.2. Herakliu me Shpendët Stimfalikë

Kthimi i Ulisit në Itakë në amforën e muzeut arkeologjik të Durrësit paraqet një karakteristikë tjetër për krijimin muzeal të Adriatikut¹⁷. Sikundër edhe skenat e Amazonomakisë të theksuara në dy gjetje nga shek. IV p. Kr. : 1) amfora që përshkruan skenën mitike të Luftës të Trojës, beteja midis Pentesileas, mbretëreshës së Amazonave dhe heroit Akil¹⁸. Kjo vepër lidhet me qytetin e Athinës (për bufin si simbol) dhe me atë të Neapolis në Italinë jugore¹⁹; 2) Lekitosi me relief i prodhimit lokal, ka një histori mjaft të veçantë. Që nga viti 1948 është

¹⁵ LIMC (1984), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Athéna II, Artemis & Winkler, Zürich, München, Düsseldorf, 184, 531, LIMC (1988), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Herakles V, Artemis & Winkler, Zürich, München, Düsseldorf, 3157, 3165, 3169, 3172. KOCILLARI J & NAZARIAN M. (2020), *LIMCicon ID 18729*, *Corpus LIMC – France*. www.limc-france.fr/objet/18729

¹⁶ WILKES J. (1998), *The Illyriens*, ECIG, Genova.

¹⁷ Enë me figura të kuqe shek. IV p. Kr. Në skenën shohim: Penelopën, Telemakun, Ulisin (kthimi në Itakë) dhe Euriklenë. HIDRI H (2005), *Vazot antike të Durrhahut*, Globus, Tirane. KOCILLARI J. (2016), *Ceramica a figure rosse in Albania produzioni e importazioni*, ExpoVision, Tiranë.

¹⁸ Inv. 5401. KOCILLARI J. (2016), *Ceramica a figure rosse in Albania produzioni e importazioni*, ExpoVision, Tiranë. TODISCO L. (2012) *La ceramica a figure Rosse della Magna Grecia e della Sicilia*, L'ERMA, Roma". TRENDALL A. D. (1974), *Early South Italian Vase – Painting*, Verlag P. von Zabern, Mainz.

¹⁹ Vepër e piktorit Napoli 2074 me influence e piktorit të Dirces.

dokumentuar binjaku i tij i ekspozuar në Muzeun e Arteve të Bukura në Bruksel (fig.3.)²⁰.



Fig. 3. Lekitos – Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu i Arteve të Bukura në Bruksel

Po kështu, edhe fragmenti i buzës së dinosit me figurë të zezë, autori i të cilit nuk dihet (fig. 4a. 4b.)²¹. Skena në fjalë evidenton një sërë hoplitësh - heroi (ose skena të mitit), duke përfshirë një person të ulur ndërsa një prej tyre hipën në karrocën e tij, si dhe praninë e anijeve dhe të një delfini²². Për analogjitë e saj kjo skenë është e pranishme edhe në dinosit e Muzeut të Madridit me të njëjtat detaje²³, si edhe në atë të muzeut të Cleveland me skenën e Herakliut (fig. 5.)²⁴. Këto vepra, si ajo e Durrësit, i atribuohen mjeshtërisë së Piktorit Atik të Antimenesit të fundit të shek. të VI. p. Kr. Skena me karrocën mund të shihet edhe në amforën e Muzeut Metropolitan të Nju Jorkut, si dhe në atë të Leidenit të Holandës (fig. 6.)²⁵. Pra, ky element i veçantë

²⁰ Inv. 9335, datimi 320 – 300 p. Kr. KOCILLARI J. (2016), *Ceramica a figure rosse in Albania produzioni e importazioni*, ExpoVision, Tiranë. MAYEMCE F & VERHOOGEN V. (1949), *CORPVS VASORVM ANTIQVORVM BELGIQUE*, Bruxelles: Musées Royaux d'Art et d'Histoire, Union Académique Internationale, Bruxelles.

²¹ Qeramikë pa autor.

²² Kur dinosi u mbush deri në buzë, anijet e pikturuara brenda dukej se po notonin në “detin e errët si verë”, një nga përshkrimet më të famshme poetike të Homerit.

²³ Madrid inv. L62; BEAZLEY J. D. (1956), *Attic Black – Figure Vase – Painters*, University Press, London; COATES J. F & MORRISON J.S & RANKOV N. B. (2000), *The Athenian Trireme: The history and Reconstruction of an ancient Greek warship*, Cambridge University Press, Cambridge.

²⁴ Mjeshtri Antimenesi: rafigurimin i Herakliut. Muzeu i Arteve Cleveland 1971.46. BERGE L & MOON W. (1979), *Greek Vase Painting in Midwestern Collections*, Art Institute, Chicago.

²⁵ MOORE M. B. (1983), *A New hydria by Antimenes Painter*, në «Metropolitan Museum Journal», n. 18, f. 29 – 38.

nxjerr në pah nevojën sesi trashëgimia arkeologjike shqiptare duhet të jetë objekt i kërkimit të kujdesshëm shkencor, por edhe krijues i itinerareve kulturore midis muzeve dhe institucioneve shkencore, që në këtë rast shohin: Durrësin, Madridin, Adrian (Itali), Cleveland-in, Luvrin - Paris (Francë) dhe Holandën.



Fig. 4a. Dinos - Durrës. Piktori Antimenes.



Fig. 4b. Skena e buzëzës. Piktori Antimenes.



Fig. 5. Cleveland (SHBA). Piktori Antimenes



Fig. 6. Leidenit. Holanda. Piktori Antimenes

2. Nikja e Apolonisë si krijuese e itinerareve kulturore

Trashëgimia kulturore shqiptare është në gjendje të flasë përmes një prej elementeve të saj pak të njohur. Nikja e Apolonisë me demin gati për sakrificë janë një element i qartë i mjeshtërisë vendase, por mbi të gjitha i atyre lidhjeve të mundshme kulturore që çojnë në krijimin e itinerareve përmes ekspozitave shqiptare dhe atyre evropiane. Nikja shfaqet me krahë, me këmbën e djathtë të mbështetur mbi demin, (fig. 7) e veshur me një kiton të gjatë²⁶. Në krahun e djathtë shohim

²⁶ CEKA N. (2005), *Ilirët*, Migjeni, Tiranë.

një shpatë dhe me të majtën mban brirët e kafshës gati për kurban (simbol i fitores)²⁷. Kjo skenë me ndikim dhe bukuri të fortë gjendet e ekspozuar në muze të ndryshme evropiane. Shfaqet gjithashtu edhe në objekte, si në statujën dhe vazon të ekspozuara në Muzeun Kombëtar të Kopenhagenit në Danimarkë²⁸; në pasqyrë, gdhendje, në Muzeun Arkeologjik të Athinës (fig. 8)²⁹; në atë të Budapestit - Szépművészeti Muzeu; në unazën e Muzeut Hermitage në Rusi; në Muzeun Britanik (fig. 9) në statujat romake (kopje e grekëve)³⁰. Rëndësia e kësaj skulpture shihet edhe në pikturën: Jan De Bisschop – 1628 – 1671, Holandez (fig. 10). Skulptura e Apolonisë është një nga shembujt për të përmirësuar trashëgiminë kulturore shqiptare. Mbi të gjitha nëpërmjet kërkimit shkencor dhe krijimit të itinerareve, ekspozitave që kalojnë përmes bashkëpunimit të institucioneve dhe muzeve të ndryshme shqiptare dhe evropiane. Ky element është pikërisht një nga ata që mund ta bëjnë të flasë trashëgiminë artistike shqiptare.



Fig. 7. Nikja Apoloni



Fig. 8. Nikja Muzeu Arkeologjik i Athinës

²⁷ Shek. III - II p. Kr. inv. 863. BORBIEN A. H. (1968), Campanareliefs: typologische und stilkritische Untersuchungen. Ergänzungsheft 14 aus der Reihe Mitteilungen des Deutschen Archäologischen Instituts, Römische Abteilung, Heidelberg, Kerle.

²⁸ Nike 715, 718. LIMC (1992), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Nike VI, Artemis & Winkler, Zürich, München, Düsseldorf.

²⁹ Inv. 16115. ICONICLIMC, *Fondation pour le Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae (LIMC)*, Nike, www.iconiclimc.ch.

³⁰ Dy statuja shek. II pas Kr nga Vila e perandorit romake Antonin Piu në Latium (Monte Cagnolo Itali). Sot në Muzeun Britanik. Inv. 1805,0703.4; 1805,0703.5. BAKER N & CRADDOCK P & JONES M. (1990), *Fake? The Art of Deception*, BMP, London. PRYCE F. N & SMITH A. H. (1892 – 1928), *Sculpture/ catalogue of Greek Sculpture in the British Museum*, BMP, London.



Fig. 9. Muzeu Britanik, Londër.



Fig. 10. Nikja me demin (Jan De Bisschop)

Përfundime

Nëse i bëjmë vetes pyetjen se si duhet ta bëjmë të flasë trashëgiminë kulturore, një përgjigje e mundshme dhe interesante vjen drejtpërdrejt nga objektet arkeologjike të ndryshme që gjenden në muzetë e Shqipërisë. Disa prej tyre, siç janë rastet e paraqitura në këtë studim, evidentojnë potencialin e tyre strategjik për t’iu përgjigjur pyetjes së mësipërme.

Artefaktet e ekspozuara në muzetë shqiptare janë, jo vetëm dëshmia që duke filluar nga antikiteti ekziston një lidhje kulturore dhe ekonomike midis realiteteve ilire dhe qyteteve të Mesdheut siç ishin poliset helene, Athina dhe Korinti, me ato të fiseve të Italisë të jugut si Apulët, Kampanët, Lukanët dhe kolonive të “Manga Grecias”, por ato evidentojnë në mënyrë të veçantë rëndësinë e Adriatikut.

Punimet e mjeshtërve atikë si Antimenesi, i cili nuk njihet në Shqipëri, apo Brygosi, me skenat e Amazonomakisë, por edhe rafigurimet e miteve si Herakliu, Uliksi dhe Akili, na ndihmojnë për të krijuar itinerare kulturore midis muzeumeve me qëllim promovimin e kulturës së antikitetit dhe lidhjeve të tyre. Fakti që këto skena mund të gjenden edhe në Muzeun Britanik, Muzeun Mbretëror të Brukselit, Muzeun Arkeologjik të Athinës, Muzeun e Cleveland (SHBA), Muzeun e Madridit, etj, dëshmon për potencialin kulturor të fshehur që mbartin këto objekte. Një ekspozitë tematike do të përfshinte muzetë shqiptarë në krah të muzeve të huaj, do të nxiste pjesëmarrjen dhe përfshirjen e institucioneve të tyre, interesin e qytetarëve, por edhe të studiuesve individualë, komuniteteve lokale (të interesuara), turizmit kombëtar

dhe mediave të huaja, universiteteve, etj. Duke vepruar kështu krijohen kushtet për zhvillimin ekonomiko-kulturor të kombit. Raste të tilla si ai i Nikjes së Apolonisë me sakrifikimin e demit, krijojnë mundësi për të vendosur lidhjet muzeale (si p.sh.: itinerari i Herakliut, i Ulksit në Adriatik), të mbështetura nga kërkimi shkencor dhe nga promovimi i institucioneve kulturore. Analiza e këtyre objekteve na konfirmojnë rëndësinë e Ilirisë në antikitet, sikurse edhe traditat, mitet e burimet historike. Ndaj, kjo trashëgimi artistike dhe kulturore është strategjike dhe e dobishme për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të zonave të ndryshme të Shqipërisë, pasi, përpos të tjerash, ndihmon në përcaktimin e gjurmëve kulturore tek ilirët.

BIBLIOGRAFIA

- BAKER N & CRADDOCK P & JONES M. (1990), *Fake? The Art of Deception*, BMP, London.
- BEAZLEY J.D. (1956), *Attic Black – Figure Vase – Painters*, University Press, London.
- BERGE L & MOON W. (1979), *Greek Vase Painting in Midwestern Collections*, Art Institute, Chicago.
- BORBIEN A. H. (1968), *Campanareliefs: typologische und stilkritische Untersuchungen* *Ergänzungsheft 14 aus der Reihe Mitteilungen des Deutschen Archäologischen Instituts, Römische Abteilung*, Heidelberg, Kerle.
- BRACESSI L. (1971), *Le rotte commerciali*, në «Grecità Adriatica. Un capitolo della colonizzazione Greca in Occidente», f. 13.
- CEKA N. (2005), *Ilirët*, Migjeni, Tiranë.
- COATES J. F & MORRISON J. S & RANKOV N. B. (2000), *The Athenian Trireme: The history and Reconstruction of an ancient Greek warship*, Cambridge University Press, Cambridge.
- COPPOLA A. (2002), *I Nomi dell'Adriatico*, në «Hespèria», n. 15, f. 103.
- DE LUCA (1985), *l'Arte albanese nei secoli*, De Luca, Roma.
- FORSDYKE E. J & SMITH C. H & WALTERS H. B. (1893 – 1925), *Vase – Catalogue of Vases in the British Museum*, I – IV, BMP, London.
- HIDRI H. (1994). *Qeramika e stilit atik e zbuluar në Dyrrah shek. VI – V p.e.sone*, në «Iliria», I II, f. 155 – 156.
- HIDRI H. (2005), *Vazot antike të Dyrrahut*, Globus, Tirane.
- ICONICLIMC, *Fondation pour le Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae (LIMC)*, Nike, www.iconiclimc.ch
- KOCILLARI J. (2016), *Ceramica a figure rosse in Albania produzioni e importazioni*, ExpoVision, Tiranë.
- KOCILLARI J & NAZARIAN M. (2020), *LIMCicon ID 18729, Corpus LIMC – France*. www.limc-france.fr/objet/18729

- LIMC (1984), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Athéna II, Artemis & Winkler, Zürich, München, Düsseldorf.
- LIMC (1988), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Herakles V, Artemis & Winkler, Zürich, München, Düsseldorf.
- LIMC (1992), *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*, Nike VI, Artemis & Einkler, Zürich, München, Düsseldorf.
- MANO A. (1981), *Tri vazo antike në Muzeun Arkeologjike i Tiranës*, në «Iliria», II, f. 95-97, tab. I. 1, 2, 3, 4.
- MAYEMCE F & VERHOOGEN V. (1949), *CORPVS VASORVM ANTIQVORVM BELGIQUE*, Bruxelles: Musées Royaux d'Art et d'Histoire, Union Académique Internationale, Bruxelles.
- MOORE M. B. (1983), *A New hydria by Antimenes Painter*, në «Metropolitan Museum Journal», n. 18, f. 29 – 38.
- NAVA M. L. (2004), *I Pirati e il Mare nelle Stelle Daunie*, në «Hespèria », n. 19, f. 75.
- PINEZZOLA E. (2002), *Adriatico e altri mari, un immagine simbolo per la Graia Camena di Orazio*, në «Hespèria», n. 15, f. 13.
- PRYCE F. N & SMITH A. H. (1892 – 1928), *Sculpture / catalogue of Greek Sculpture in the British Museum*, BMP, London.
- TODISCO L. (2012) *La ceramica a figure Rosse della Magna Grecia e della Sicilia*, L'ERMA, Roma”.
- TRENDALL A. D. (1974), *Early South Italian Vase – Painting*, Verlag P. von Zabern, Mainz.
- ËILKES J. (1998), *The Illyrians*, ECIG, Genova.

RËNDËSIA E KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE DHE SHUMËGJUHËSORE NË INDUSTRIJË E TURIZMIT NË SHQIPËRI

Dr. ARDITA DYLGJERI

Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
arditadylgjeri@live.com

Msc. IRGEN XHYRA

Gjimnazi Gjuhësor "Mahmut e Ali Cungu"
irgen.xhyra@gmail.com

ABSTRACT

